

PERSHKRIMI TEKNIK I VNM-se PER PROJEKTIN " SHFRYTEZIM I MINERALIT TE KROMIT SKROSKE ME NR.516/7 TE ZONES MINERARE " ne Qarkun e Elbasanit, Bashkia Prrenjas, Fshati Skroske



PERSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT U PERGATIT NGA GRUPI I PUNES I PERBERE NGA:

Expert Mjedisi. Kristaq GJOKA



Expert Mjedisi Yzeir MIRAKA



MSc. Ing. Mjedisi Bestar CEKREZI



KONSULENTI:

ZENIT & CO SH.P.K.

ADMINISTRATORI

**ARQILE PERI
ZENIT CO
K617310
02D**

Digitally signed
by ZENIT CO
K61731002D
Date: 2021.01.28
10:37:15 +01'00'

INVESTITOR:

ELBESA SH.P.K

ADMINISTRATORI

BESNIK PISHA



TIRANE, Janar 2021

(Azhornuar)

PERMBAJTJA

PERMBAJTJA.....	2
1. PARATHENIE	4
2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT	5
2.1 QELLIMI I PROJEKTIT	5
2.2 KUADRI LIGJOR	6
➤ KLASIFIKIMI I PROJEKTIT	9
2.3 VENDODHJA GJEOGRAFIKE E PROJEKTIT	10
2.4 VENDODHJA ADMINISTRATIVE	12
2.5 TOPOGRAFIA DHE MORFOLOGJIA.....	13
2.6 PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE KLIMATIKE.....	16
2.7 NDIKIMI NË HABITAT DHE OBJEKTET ME STATUS TË VENÇANTË.....	17
3. SKICAT DHE PLANIMETRIT KRYESORE TE PROJEKTIT	18
4. PERSHKRIMI I PROCESVEVE NDERTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE	23
4.1 HAPJA DHE SHFRYTEZIMI I VENDBURIMIT TE MINIERES.....	24
4.2 LENDET E PARA QE DO TE PERDOREN	26
4.3 AKTIVITETE TE TJERA QE KERKON PROJEKTI	26
4.4 PRODUKTI	26
5. TE DHENA PER INFRASTRUKTUREN,FURNIZIMIN ME UJE ,SHKARKIMET E UJRAVE DHE MBETJEVE,RRUGET EKZISTUESE DHE HAPJA E RRUGEVE TE REJA.....	26
5.1 FURNIZIMI ME UJE.....	26
FURNIZIMI ME UJE DO TE BEHET NE RRJETIN E ZONES EDHE ME ANE TE NJE POMPE E CILA DO TE DERGOJE UJIN EN NJE DEPOZITE E CILA DO TE VENDOSSET NE PIKEN ME TE LARTE TE MINIERES KU ME PAS DO TE RRJEDHE ME GRAVITET (RRJEDHE TE LIRE). NE KETE MEYRE BEHET E MUNDUR EDHE KURSIMI I ENERGJISE.....	26
5.2 FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE	26
5.3 RRUGET EKZISTUESE DHE RRUGET E REJA	27
5.4 SHKARKIMET E ALUVJONEVE.....	27
6. PROGRAMIN PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN E NDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR PËR FUNKSIONIMIN E PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE,	

SIPAS RASTIT, EDHE FAZËN E PLANIFIKUAR TË REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES, PAS MBARIMIT TË	
FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT	27
6.1 KOHEZGJATJA E NDERTIMIT DHE OPERIMIT	27
6.2 PERSHKRIMI FLORES EDHE FANUES.....	28
6.3 PERSHKRIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS	30
6.4 MASAT ZBUTESE PER NDIKIMET NE MJEDIS	36
6.4 MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA	39
6.4.1 Sasise se gjenerimit te mbetjeve	39
6.4.2 Trajtimi i mbetjeve.....	40
6.4.3 Transportimi i mbetjeve	41
6.4.4 Asgjesimi i mbetjeve	41
7. LIDHJET E MUNDESHME TE PROJEKTIT ME PROJEKTE TE TJERA EKZISTUESE, PRANE ZONES SE	
PROJEKTIT.....	42
7.1 LIDHJA E PROJEKTIT ME INFRASTRUKTUREN E ZONES	42
7.2 ALTERNATIVAT E MARRA NE KONSIDERATE PER VENDODHJEN E PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISE QE DO TE PERDORET	42
7.3 PERDORIMI I LENDEVE TE PARA GJATE FUNKSIONIMIT (SHFRYTEZIMIT) ,UJE ,ENERGJI ,LENDE DJEGESE DHE MENYRA E SIGURIMIT	
TE TYRE	44
7.4 AKTIVITETE TE TJERA QE NEVOJITEN PER ZBATIMIN E PROJEKTIT (NDERTIMI I KAPANONEVE APO REZIDENCEVE).....	44
8. INFORMACION PER LEJET ,AUTORIZIMET DHE LICENSAT ,SIPAS LEGJISLACIONIT NE FUQI,PER	
LEJIMIN,AUTORIZIMIN, LICENSIMIN E PROJEKTIT	44
9. KOPJE TE LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE LICENSAVE QE DISPONON ZHVILLUESI PER PROJEKTIN E	
PROPOZUAR , NE PERPUTHJE ME PERCAKTIMET E BERA NE LEGJISLACIONIN NE FUQI, SI DHE INSTITUCIONET	
KOPRETENTE PER LEJIMIN/AUTORIZIMIN/LICENSIMIN E PROJEKTIT.	45

1. PARATHENIE

Subjekti "ELBESA" shpk; është një shoqëri eksperience shume vjeçare ne shfrytezimin dhe perpunimin e mineralit te kromit e regjistruar ne vendin tonë NUIS K33219201C me adrese: Ish Kombinati Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan. Gjate aktivitetit te saj ajo ka akumuluar një eksperiencë shume vjeçare në fushën e këkim-zbulim- shfrytëzimit dhe tregetimit te mineraleve dhe ka mundësi financiare për realizimin e investimeve të parashikuara për kryerjen e aktivitetit minerar të shfrytëzimit të mineralit te kromit në objektin e kërkuar për marrjen e lejes mierare.

Zona minerare e cila do te shfrytezohet eshte Nr. 516/7 ne Bashkine Prrrenjas, fshati Skroske, ku Kompania ELBESA sh.p.k eshte shpallur fituese ne garen e tenderimit nga ana e Ministrise se Infrastrkutures edhe Energjise per shfrytezimin e kesaj zone minerare te kromit per nje periudhe 3-vjecare. Sasia e kromit qe do te nxirret nga kjo miniere eshte llogaritur 2500 ton/vit dhe vlera e investimit eshte parashikuar 8 600 000 leke per 3 vitete e shfrytezimit te Minereres. Vlera e perfituar nga ky aktivitet eshte parashikuar 30 250 000 leke. Siperfaqja qe do te shfrytezohet eshte 0.077 km2 ose 7.7 Ha.

Shrytëzimi do të bëhet me punime nentokesore, në perputhje me kërkesat e ligjit Nr 10304, date 15/07/2010 "Per Sektorin Minerar ne Republikën e Shqiperise", si dhe të të gjitha akteve nënligjore të dala në zbatim e për zbatim të tij.

Zona Nr 516/7, si dhe zonat e tjera konkurrese, është publikuar për procedure konkurimi sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", pikës 5 dhe pikave 7/7 e 7/8 të VKM nr. 320, datë 21.04.2011 "Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurrese", Urdhrit të Ministrit të Energjise dhe Industries, Nr 107, date 10.03.2014 "Për miratimin e Planit Vjetor Minerar 2014". Me ane te njoftimit Nr. Prot. 7572/1 nga ana e Ministrise se Infrastruktures edhe Energjise shoqeria ELBESA sh.p.k eshte shpallur fituese per shfrytezimin e kromit ne kete zone minerare.

Projekti ne fjale i neshtrohet procedures se VNM-se se thelluar bazuar ne Ligjin Nr. 10 440, datë 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" i ndyshuar, Neni 9, procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: projektet e listuara në shtojcën I; pika 19: Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Qellimi i Projektit

Qellimi i projektit eshte shfrytezimi i mineralit te kromit nga zona minerare Nr. 516/7 Skroske, prrenjas, Qarku i Elbasanit. Kompania ELBESA sh.p.k eshte shpallur fituese ne garen e tenderimit nga ana e Ministrise se Infrastruktures edhe Energjise per shfrytezimin e kesaj zone minerare te kromit per nje periudhe 3- vjecare. Sasia e kromit qe do te nxirret nga kjo miniere eshte llogaritur 2500 ton/vit dhe vlera e investimit eshte parashikuar 8 600 000 leke per 3 vitete e shfrytezimit te Minereres. Vlera e perfituar nga ky aktivitet eshte parashikuar 30 250 000 leke. Siperfaqe qe do te shfrytezohet eshte 0.077 km² ose 7.7 Ha. Sasia e kromit qe do te nxirret do te tregtohet ne tregun vendas edhe per eksport.

Ne objekt eshte kryer nje mori punimesh gjeologjike te kerkim-zbulimit te tipit kanale pastrime etj . Rezultatet e mara nga keto punime te kryer nga ish ndermarja minerare e kromit Perenjas si dhe dokumentimet e ndryshme, te kryera nga vete subjekti gjate kryerjes se punimeve te dokumentuese ne zonen e objektit , kane sherbyer si baze per hartimin e pjeses grafike dhe projektit te shfrytezimit te ketij objekti .

Miniera e kromit Skroske ka filluar shfrytezimin ne vitin 1988, mbi bazen e projekt idese te hartuar ne vitin 1987. Baze per hartimin e ketij projekti dhe fillimin e aktivitetit minerar, ne vendburimin e kromit Skroske ka qene relacioni gjeologjik i dhene nga Ndermarrja Gjeologjike Pogradec, Prrenjas, Librazhd me gjendje rezervash 01.03.1987 si me poshte:

- Rezerva te kategorise C1 - 67 292 tone
- Rezerve te kategorise C2- 16 567 tone
- Gjithsej C1+C2- 83 859 tone

Permbajtja mesatare e Cr₂O₃ ne bllok per vendburimin ka rezultuar 36-42%.

Per hartimin e ketij studimit tekniko-ekonomik dhe projektit te shfrytezimit te ketij objekti kromi jane mare ne konsiderate:

- Pozicioni gjeografik dhe mardheniet e objektit me qendrat e banuara, kryesisht me qytezen e Perenjasit, qe ndodhet rreth 7 km larg ne vije ajrore nga objekti, 16 km nga qyteti i Librazhdit (vije ajrore) edhe 4.2 km nga ura e Bushtrices (rruga automobilistike).
- Kushtet e pergjitheshme si dhe topografia dhe klima e zones, ne te cilen ndodhet objekti i qe parashikohet ti nenshtrohet shfrytezimit;
- Hidrologjia, hidrogeologjia dhe hidrografia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit;
- Gjendja, ne pergjithesi e infrastruktures se rajonit dhe te zones se objektit, mundesite e permiresimit te saj, ndertime dhe instalime te tjera te domosdoshme per shfrytezimin e objektit nga pikpamja minerare;
- Materiali gjeologjik baze lidhur me ndertimin gjeologjik te rajonit dhe vendburimit, sasine dhe cilesine e rezervave gjeologjike dhe te shfrytezueshme brenda kufijve te percaktuar te shfrytezimit si dhe eksperiencon e aktivitetit minerar ne kete miniere;
- Eksperiencon e grumbulluar gjate kryerjes, nga ish Ndermarrja Gjeologjike e Pogradecit, Prrenjasit dhe Librazhdit dhe te ish Minereres se kromit Skroske, asaj te Bushtrices dhe Katjelit, te punimeve gjeologjike, qe lidhen kerkim zbulimin e ketij vendburimi dhe kryesisht te dhenat lidhur me

- qendrusherme e shkembinjve qe ndertojne objektin si dhe te trupave xeherore te konkretizuar ne te si dhe punimeve te ndryshme minerare te pergatitjes dhe shfrytezimit;
- Hidrogeologjia e objektit dhe raporti me ujrat nentokesore dhe siperfaqesore si dhe ato te shtratit te lumit te Bushtrices
 - Sasite e rezervave ne trupat e objektit qe do te merren ne konsiderate elementete shtruarjes, rezervat. pametrat gjeometrike dhe thellesine ndodhjes se rezervave
 - Punimet minerare gjeologo-zbuluese dhe ato te pergatitjes e shfrytezimi te hapura, gjendja e tyre dhe mundesia e riperdorimit te tyre;
 - Nevojat per kryerjen e punimeve te ndryshme te reja per hapjen, pergatitjen dhe shfrytezimin e objektit;
 - Kerkesat e ndryshme per makineri, pajisje, instalime dhe investime te tjera per pergatitjen dhe shfrytezimin e objektit;
 - Llojet e produkteve te prodhuara ne sasi dhe cilesi, trajtimi i tyre si dhe tregu i shitjes se tyre dhe çmimet;

Objekti perfshihet ne nje vendburim kromi ne te cilin eshte shfrytezuar mineral kromi ne zone e perfshire midis galerive te hapura te ish minieres midis kuotave +510 deri +545 Vendburimi eshte shfrytezuar pjeserisht ne pjesen e siperme nga vitet 2018-2019 dhe eshte braktisur ne vitin 2019, pas perfundimit te shfrytezimit te rezervave te objektit ne pjesen e siperme te tyre.

Nga kjo kohe, galerite e hapura si dhe furnelet qe kane sherbyer per te pergatiturr rezervat jane braktisur dhe nuk jane aktivizuar me. Ne projekt parashikohet te shfrytezohen rezervat e mbetura te trupit, ne pjeset me te poshteme si dhe mbetjet e tjera teknologjike (tanike), te cilat gjate ketyre viteve nuk jane shfrytezuar.

2.2 Kuadri ligjor

Qëllimi i VNM-së është të vlerësojë ndikimet negative dhe pozitive të projektit si dhe të paraqesë masat që duhet të aplikojë kompania për reduktimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis dhe komunitet.

- **Objektivat e VNM-së**

Objektivi kryesorë i raportit të VNM-së është që të përmbushë kërkesat e legjislacionit shqiptar, me qëllim që të kemi një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor. Objektivat specifike të VNM-së janë:

- Të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e rëndësishme mjedisore nga zhvillimi i projektit
- Për të përcaktuar përpuethshmërinë e projektit të propozuar me përdorimin e tokës dhe të
- Vlerësojë kushtet lokale mjedisore
- Për të parë avantazhet nga zbatimi i këtij projekti
- Për të vlerësuar dhe zgjedhur alternativën më të mirë nga opsionet e mara në studim
- Të përfshijë planet e menaxhimit Mjedisorë dhe mekanizmat monitoruese gjatë fazave të
- zbatimit dhe funksionimit të projektit.

➤ **Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin**

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekti i propozuar. Ky raport i Vlerësimit të ndikimit në Mjedis është hartuar duke patur parasysh legjislacionin e shtetit shqiptar dhe të Komunitetit Europian, me akte juridike ligjore dhe nënligjore specifike që rregullojnë ushtrimin e aktivitetit të investimeve dhe gjithashtu aktet ligjore lidhur me mbrojtjen e mjedisit si më poshtë:

➤ **Përmbledhja e legjislacionit**

- Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
- Ligji Nr.10 431, datë 09.06.2011, "Për Mbrojtjen e Mjedisit"
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit"
- Ligji Nr.10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003, "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta"
- Ligji Nr. 8094, datë 24.04.2003, "Për largimin publik të mbeturinave"
- Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"
- Ligji Nr. 9108, datë 17.7. 2003, "Për Substancat dhe Preparatet Kimike"
- Ligji Nr.8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me: Ligjin Nr.9826, datë 1.11.2007
- Ligji Nr. 12/2015, datë 26.02.2015 për disa ndryshime në ligjin Nr 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
- Ligji Nr.81, datë 4.05.2017 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligji Nr. 9868, date 4.02.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligji Nr.10006, datë 23.10.2008" Për mbrojtjen e faunës së egër", i ndryshuar
- Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar
- Ligji Nr 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji Nr.10266, datë 15.04.2010 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
- Ligji Nr.9425, datë 06.10.2005 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe"
- Ligji Nr.10 422, datë 26.05.2011 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në rreze të gjatë" për financimin afatgjatë të programit bashkëpunues për monitorimin e vlerësimin e transmetimit në rreze të gjatë të ndotësve të ajrit në Europë (EMEP)
- Ligji Nr.10 476, datë 3.11.2011 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, për të pakësuar acidifikimin, eutrofikimin dhe ozonin në shtresën e poshtme të atmosferës"
- Ligji Nr.10 062 , datë 29.01.2009 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare " të konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"

- Ligji Nr.9548 , datë 01.06.2006 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e regjistrave të shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve
- Ligji Nr.10 063 , datë 29.01.2009 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30%" " të konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"
- Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë"
- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve" i ndryshuar: VKM Nr. 579, datë 3.9.2014
- VKM Nr. 13, datë 13.01.2013, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis"
- VKM Nr. 419, datë 25.06.2014, "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi tipi A, B dhe C"
- VKM Nr. 676, datë 20.12.2002, "Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror"
- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse"
- VKM Nr.435 datë 12.09.2002, "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- VKM Nr. 247, datë 30.4.2014, "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"
- Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të Deklaratës Mjedisore"
- Udhëzim Nr. 3, datë 03.09.2009, "Për metodologjinë e vlerësimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis"
- Vendim Nr. 371, date 11.6.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"
- VKM-së Nr. 866, datë 4.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
- Vendim Nr. 352, datë 29.04.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të"
- Vendim Nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"
- Vendim Nr,781, datë 14.11.2012 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lengëshme për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim mjetet e transportit ujor (detar,lumor dhe liqenor)
- Vendim Nr,248, datë 24.04.2003 "Për miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër dhe zbatimin e tyre"
- Vendim Nr,435, datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- Vendim Nr,803, datë 04.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit"
- Vendim Nr,781, datë 14.11.2012 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lengëshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorimin e mjeteve të transportit ujor (detar,lumor dhe liqenor)"

- Vendim Nr.123, datë 17.02.2011 "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis"
- Vendim Nr.587, datë 07.07.2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike"
- VKM nr. 320, datë 21.04.2011 "Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese"
- Urdhri i Ministrise së Energjise dhe Industries, Nr 107, date 10.03.2014 "Për miratimin e Planit Vjetor Minerar 2014".

Ligji Nr. 10 440, datë 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

- a) Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) Garantim i një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Sipas kreut II, neni 7 "Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis" i këtij ligji citojmë:

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.
2. Proçedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:
 - a) Proçesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis
 - b) Proçesin e thelluar të vlerësimi të ndikimit në mjedis

Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për Mbrojtjen e Mjedisit"

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njëriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vëndit.

Në bazë të këtij ligji, neni 3 i tij, citojmë objektivat e mbrojtjes së mjedisit.

- a. parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d. përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f. mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit

➤ **Klasifikimi i projektit**

Bazuar në ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" (I ndryshuar), kreu II, neni 7, "Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.

Klasifikimi i raportit të VNM-së bazohet në shtojcat I dhe II të veprimtarive të përcaktuara në shtojcat e ligjit të VNM-së.

- Neni 8, projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë: projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur ligjit të VNM-së;
- Neni 9, procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: projektet e listuara në shtojcën I;
- Neni 11, Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për VNM-në paraprake: Në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së, AKM-ja merr vendim nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.

Projekti në studim është objekt i ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, shtojca I:

Pra, projekti në fjale i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar bazuar në Ligjin Nr. 10 440, datë 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar, **Neni 9**, procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: projektet e listuara në **shtojcën I**; pika 19: Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar. Sipërfaqja e projektit përfshin një sipërfaqe prej 7.7 Ha.

Klasifikimi i projektit ose veprimtarisë:

VNM e thelluar	X
VNM paraprake	
Nuk ka nevojë për VNM	

Mbështetur në këtë klasifikim ligjor raporti i thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të hartohet sipas kërkesave të Vendimit nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

2.3 Vendodhja Gjeografike e Projektit

Vendodhja e projektit ndodhet në Qarkun e Elbasanit, Bashkia Prrenjas, njesia administrative Qukes, fshati Skroske me Nr të zonës së minierës 516/7 Skroske. Ndodhet në një largësi rreth 4.2 km nga rruga automobilistike Librazhd-Prrenjas (nga ura e Bushtrices). Ndersa në vijë ajrore është një largësi 7 km nga qyteti i Prrenjasit edhe 16 km nga qyteti i Librazhdit. Objekti ben pjesë planshetin K-34-101-D-b të shkallës 1:25 000 dhe kufizohet nga koordinata sipas sistemit gjeografik Gauss Kruger:

Pika	Koordinatat Gauss Kruger	
	E=X	N=Y
1	45 54 097	44 57 001
2	45 54 261	44 56 881
3	45 54 440	44 57 207
4	45 54 256	44 57 325

Tablea 1- Koordinatat e projektit ne Gaus Kruger




Figura 1- Planvendosja e projektit ne harte topografike shk 1: 25 000

2.4 Vendodhja administrative

Projekti zhvillohet ne qarkun e Elbasanit, dhe me ndarjen e re territoriale shtrihet bashkine e Prrrenjasit, Njesia Administrative Qukes, Fshati Skroske.



Figura 2- Harta Territoriale e Qarkut Elbasan

Qarku Elbasan shtrihet ne zonen qendrore te Shqiperise. Ka nje siperfaqe te pergjithshme prej 3292 km² dhe nje popullsi prej 433.244 banore. Kufizohet ne veri dhe veriperendim me qarkun e Tiranës, ne lindje dhe juglindje me qarkun e Korces, ne perendim dhe jugperendim me qarkun e Beratit. Administrativisht, Qarku ka 7 bashki (Elbasan, Librazhd, Peqin, Belsh, Prrrenjas, Gramsh, Cerrik), 43 njesi administrative dhe 386 fshatra.

Përrenjasi kufizohet në veri me bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Përrenjasit.



Figura 3- Harta Administrative e Bashkise Prrrenjas

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Përrenjas, Qukës, Rrajcë dhe Stravaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 25 fshatra.

Sipas Censurit të vitit 2011, Përrenjasi ka një popullsi prej 24,906 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 33,031 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322.95 km². Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km² ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 102.279 banorë/km².

Klima e Qarkut Elbasan karakterizohet nga një klimë mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Reshjet bien kryesisht në stinën e dimrit dhe të vjeshtës me një mesatare prej 1490 mm në vit. Temperatura mesatare vjetore është 15.4°C. Për sa i përket relievit 38% e përbejnë malet, 28% e përbejnë fushat dhe 34% e përbejnë kodrat.

Qarku përshkohet nga dy lumenj: Shkumbini e Devolli. Arteri kryesor hidrografik i Qarkut është lumi Shkumbin që rrjedh nga juglindja drejt perëndimit duke e ndarë rrethin e Elbasanit në dy pjesë të barabarta. Ka një sipërfaqe të pellgut ujembledhës 1062 km² dhe gjatësi 90 km. Gjate rrugës merr shumë përrenj si: Rrapuni, Gostima, Shushica, Zaranika, Manazderia, etj.

Në pasuritë hidrografike të Qarkut të Elbasanit hyjnë edhe rezervuarët dhe liqenët. Rrethi i Elbasanit ka një sipërfaqe ujore rreth 650 ha të cilat përbehen nga liqene natyrore dhe rezervuarë të ndërtuar për qëllime vaditjeje. Përkatesisht rezervuarët zënë një sipërfaqe prej rreth 342 ha dhe janë rreth 33 të tilla, ndërsa liqene janë 34 të tilla dhe zënë një sipërfaqe prej 310 ha. Kur flasim për liqenët natyrore nënkuptojmë zonën e Dumresë. Numri prej 34 që përmendem më lart është me i madh gjatë dimrit, por ky pakesohet gjatë verës sepse shumë prej tyre janë të ceket dhe thahen.

2.5 Topografia dhe morfologjia

Nga pikepamja e relievit, vendburimi i kromit Skroske është i vendosur në një terren kodrinor të thyer. Kuota më e sipërme e terrenit është +700 dhe kuota më e poshtme +500. Terreni kodrinor ka favorizuar hapjen e vendburimit me punime horizontale nga sipërfaqja. Terreni është tipik malor. Relievi i zonës përfaqësohet nga një shpat me rnie të pergjithëshme drejt ve-riut me kënd të fortë rnie rreth 25-30°, por në disa raste ka pjerrësi më të madhe. Shpati është i aksi-dentuar nga kater përrenj me drejtim rrjedhje jug-veri.



Figura 4- Pamja e Lugines ku ndodhet miniera



Figura 5- Pamje nga zona e minieres



Foto 6- Pamje nga zona e minieres



Foto 7- pamje nga zona e minieres



Foto 8- Pamje nga Miniere

Gjithë rajonin e këtij sektori në kemi të bejme me rajon maloro-kodrinor dhe lugina në forme V, si dhe gropa të madhësive të ndryshme. Gati në qendër të zonës kalon një rrugë e Bushtrices që ka prurje relativisht të qendrueshme të ujit.

Zona është e përshkruar nga rrugë të kategorisë së katërt dhe në lindje të saj kalon rruga e kategorisë së tretë që shkon drejt fshatit Skroske dhe me tutje për të lidhur fshatrat e zonës. Objektet lidhen me rrugë automobilistike rurale të kategorisë së pestë si dhe me rrugën nacionale Pogradec-Perrenjas-Librazhd –Elbasan e me tutje që duhet të themë se kjo është në gjendje të mirë.

2.6 Përshkrimi i karakteristikave klimatike

Territori i zonës së sipërcituar karakterizohet nga klima tipike kontinentale, me verë të freskët dhe dimër të ftohtë dhe të acartë. Gjatë verës temperaturat arrijnë deri në +20 deri +25°C, ndërsa në dimër ato zbrasin deri në -15 apo -20°C. Temperatura mesatare vjetore luhet në kufijtë e +5 deri në +10°C, por edhe më pak. Vera është e thatë me pak rreshje shpesh në formë rrebeshi të shoqëruar me rufe karakteristike kjo për zonat malore. Gjatë dimrit bien rreshje të shumta debore lartësi e se cilës shkon në 1-2m, por shpesh edhe më shumë.

Bora fillon të bjere në fillim të nëntorit, por ka raste dhe më heret dhe vazhdon të bjere pothuajse pa ndërprerje deri në fund të muajit Mars, gjithashtu ky territor rrihet pothuajse gjatë gjithë vitit nga erera me shkallë mesatare deri të forta, por me se shumti në fillim të vjeshtës deri në fundin e pranverës që vijne nga Qafa e Murrës. Këto kushte klimatike çojnë shpesh në ndërprerje të punës nga ana e subjektit sidomos në periudhën Nentor-Mars në punimet sipërfaqësore, periudhë e cila është marrë parasysh nga subjekti gjatë periudhës së shfrytëzimit të rezervave të zbuluara në këto shesh të lejes minerare.

Rrjeti hidrografik në këto zone është mjaft i zhvilluar dhe përfaqësohet nga kater perrenj malore që janë; Perroi i Kungulleshës në lindje, Perroi i Peshkut dhe i Varices në mes dhe ai i Shesheve në

perendim. Ky eshte me uje pothuajese gjate gjithe vitit, pasi furnizohen nga liqenet malore akullnajore te Kacnise qe ndodhen ne nje lartesi mbi 1800 m dhe theksojme se ne kohe rreshjesh jane te rrembyeshem per shkak te pjerresise se madhe te shpatit duke u bere shpesh te pakalueshem, pasi sjellin masa te konsiderueshme prurjesh te ngurta. Gjate veres kane pak uje e ka raste qe dhe mund te thahen.

Nga ana hidrografike mund te themi se objektet kane kushte te favoreshme pasi daljet kromitike jane ne pjeset me te larta te relieve te kesaj zone. Gjithashtu mund te se dhe kushtet hidrogeologjike te zones jane te thjeshta, pasi niveli i ujerave nentokesore eshte relativisht thelle dhe rrjeti hidrografik luan rol pozitiv duke shryer si drenazh i ujerave dhe krijuar kushte per kryerjen e punimeve te kerkim-zbulimit.

2.7 Ndikimi në habitat dhe objektet me status të veçantë

Miniera e Skroskes e cila ka qene miniere egzistuese qe prej 1988, me periudha te ndryshme kohore deri 2019, ndodhet 1.1 km ne vije ajrore nga zona e mbrojtur parku kombetar Shebenik- Jabllanice (kategoria II), shpallur me ane te te VKM Nr.640, datë 21.05.2008.




Figura 9- Distanca me e afert e projektit me zonen e mbrojtur

Punimet qe do te kryhen ne miniere me nje afat kohor 3 vjecar nuk do te ndikojne drejtpersedrejti ne zonen e mbrojtur, parku kombetar pasi ndodhen ne nje distance te konsiderueshme edhe mjetet qe do te perdoren per nxjerrejen e Kromit do te jen penumatike, qe nuk krijojne nivel te larte zhurmash ne mjedis.



Figura 10- Vaska e Peshkut

Gjithashtu ne afersi te projektit ndodhet edhe nje vaske peshku, 300 m larg nga miniera, qe ndodhet ne pjesen e poshtme te projektit (Jug-perendeim). Gjate punimeve duhet te kete kujdes qe mos te ndotet uji ne lumin e Bushtrices. Kompania do marre te gjitha masat e nevojshme qe mos te kemi ndotje ne uje gjate kryerjes se punimeve.

Projekti nuk prek mjedisin ndërkufitar. Projekti ne fjale zhvillohet i gjithe ne territorin e republikes se Shqiperise.

3. Skicat dhe planimetrite kryesore te projektit

Formacionet shkëmbore nga të cilat ndërtohet vendburimi në fjalë dhe mbi të cilat do të zhvillohet veprimtaria minerare, klasifikohen ne grupin e I-rë (shkëmbinj te forte), me qëndrueshmëri të mire, gjatë hapjes dhe zhvillimit të punimeve minerare nëpër to. Nëpër zonat tektonike, ku është rritur shkalla e serpentinizimit të shkëmbinjve mëmë, ulet ndjeshëm qëndrueshmëria e tyre.

Sistemi per shfrytëzimin e minieres eshte ai me nenkate (rekomandohet). Lartesia e katit do te jete ne vartesi te dimensioneve ne renie te trupave minerare, pasi sipas shkalles se njohjes se trupave ne kete vendburim ka luhatje te medha dhe trashesi e trupave eshte e vogel. Lartesi e nenkatit do te jete 5-6-8 m, por gjithnje kjo do te gjykohet sipas situates konkrete. Lartesi kati per panelin +535, +570 do te jete 35 m ndersa ndersa nen nivelin +510 do te jete 25m.

Per pjesn nen kuoten +510m, ne varertesi te rezervave qe eventualisht mund te zbulohen do te percaktohet ne nje faze te mevonshme me projekt qe do te hartohet nga drejtuesit e minieres. Kjo eshte e kushtezuar edhe nga ekzistenca e trupave te mineralit te cilat ne kete vendburim jane mjaft te coptuar nga tektonike dhe te paqendrueshem ne trashesi. Per mbetjet e shfrytëzimit do te hartohet

pasaporte e veçante per shfrytezimi e secilit sipas kushteve specifike duke u realizuar gjithnje ne prezence te drejtuesit teknik.

- Gjatesia e bllokut 16-20-25m
- Lartesia e nenkatit 5-6-8m
- Largesia e hinkave te vjelejes se mineralit 4-6m.

Per rrezimin e mineralit do te perdoren bira me thellesi 2-2.5 m. Birat do te behen me çekiçe shpues te zakonshem me mbajtese pneumatike, ne tavan te galerise se nenkatit. Marrja e bllokut, sipas rrethanave do te behet nga kufiri per ne qender mbasi blloku parashikohet te pergatitet me oxhak ne qendert te tij . Gjatesia e nenkatit eshte e vogel 15-18 m dhe oxhaku qendror ne profilin 2-2 e ndan ate ne dy pjese relativisht te shkurtra .




Figura 11- Planvendosja e Minieres ne Harte Topografike




Figura 12- Harta Gjeologj Topografike e zones se projektit




Figura 13- Prerjet gjeologjike




Figura 14- Planimetria e punimeve minerare




Figura 15- Planimetria e mbylljes se minieres minieres

4. PERSHKRIMI I PROCESIVE NDERTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE

Punet ndertimore te lidhura ngushtë me realizimin e projektit parashikohen si me poshte:

- Ngritje kantieri dhe vendosja e e zyres
- Rikonstruksioni i rrugeve te aksesit
- Lidhja me rrjetin elektrik te zones
- Ndertimi i nje mur mbajtes i sheshit prane hyrjes se galerise +550
- Ndertimi I nje kanali per kullimin e ujrave
- Punime per hapjen e puseve dhe nxjerrës se mineralit
- Ndertimin e te gjitha veprave me permasa te caktuara ne projekt
- Transporti i mineralit te kromit per ne hyrjen e galerise
- Transporti i Mineralit te kromit per ne piken e grumbullimit
- Mbyllja e e hyrjeve te galerise per siguri teknike pas mbarimit te punimeve



Figura 16- Ure lidhese ne kuoten +530

- *Proceset kryesore te projektit:* Shfrytezimi i mineralit te kromit per tregtim vendas edhe eksport
- *Kapaciteti :* 2 500 ton/vit mineral kromi.

4.1 Hapja dhe shfrytezimi i vendburimit te minieres

Shfrytezimi do të bëhet me punime nentokesore, në përputhje me kërkesat e ligjit Nr 10304, date 15/07/2010 "Per Sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", si dhe të të gjitha akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Vendburimi i kromit Skroske per vete pozicionin e vendosjes, ne terren kodrinor eshte hapur kryesisht me punime horizontale. Duke filluar nga lart-poshte niveli +661 eshte niveli me i siperm i pergatitjes dhe shfrytezimit. Nivelet e tjera poshte tij u hapen cdo 20-30 metra lartesi.

Punimet kryesore te katit u hapen me seksion 5.2 m2. Kane ecur ne pergjithesi ne formacione me qendrueshmeri te mire. Gjate hapjes nuk eshte perdorur armatim, me perjashtim te hyrjeve dhe kryqezimeve e zonave tektonike.

Ne shfrytezimin e trupit te kromit eshte perdorur sistemi i shfrytezimit me galeri nenkati e me hapësira te hapura pas shfrytezimit. Per trashesine e vogel te trupit (mesatarja 0.8 m), lartesia e nenekateve eshte marre jo me e madhe se 6 metra.

Mbeshtetur ne analizen qe i eshte bere treguesve te humbjes e varferimit nga specialistet ne projekt programet vjetore qe nga viti 1988 e deri ne vitin 1992 rezultojne keta treguesat:

- Humbjet e mineralit 14-16.5% mesatarisht 15%
- Varferimi i mineralit 17.9-20%, mesatarisht 18%

Pjesa e varferuar e mineralit do te seleksionohet me dore per te mudesuar prodhimin e mineralit me permbajtje gati sa ajo ne bllok.

Per trupa te tille ne shfrytezim ne kete miniere eshte perdorur sistemi i shfrytezimit me galeri nenkati. Ky sistem rekomandohet edhe ne te ardhmen ku lartesia e katit do te jete ne vartesi te dimensioneve ne renie te trupave minerare, pasi sipas shkalles se njohjes se trupave ne kete vendburim ka luhateje te medha dhe trashesi e trupave eshte e vogel. Lartesi e nenkatit do te jete 5-6-8 m, por gjithnje kjo do te gjykohe sipas situates konkrete.

Lartesi kati per panelin +535--570 do te jete 35m ndersa ndersa nen nivelin +510 do te jete 25m. Per pjesn nen kuoten +510m, ne vartesi te rezervave qe eventualisht mund te zbulohen do te percaktohet ne nje faze te mevonshme me projekt qe do te hartohet nga drejtuesit e minieres. Kjo eshte e kushtezuar edhe nga ekzistenca e trupave te mineralit te cilat ne kete vendburim jane mjaft te coptuar nga tektonike dhe te paqendrueshem ne trashesi. Per mbetjet e shfrytezimit do te hartohet pasaporte e veçante per shfrytezimi e secilit sipas kushteve specifike duke u realizuar gjithnje ne prezence te drejtuesit teknik.

- Gjatesia e bllokut 16-20-25m
- Lartesia e nenkatit 5-6-8m
- Largesia e hinkave te vjelejes se mineralit 4-6m.

Per rrezimin e mineralit do te perdoren bira me thellesi 2-2.5m. Birat do te behen me çekiçe shpues te zakonshem me mbajtese pneumatike, ne tavan te galerise se nenkatit. Marrja e bllokut, sipas rrethanave do te behet nga kufiri per ne qender mbasi blloku parashikhet te pergatitet me oxhak ne qendert te tij. Gjatesia e nenkatit eshte e vogel 15-18 m dhe oxhaku qendror ne profilin 2-2 e ndan ate ne dy pjese relativisht te shkurtra.

Radha e drejtimi i shfrytezimit

Me marrjen e lejes se shfrytezimit ne objekt do te behet ringritja e punimeve panelin +570 si dhe do te riparohet pjeserisht fyrja e galerise +580 qe do te sherbeje si punim ajrimi dhe rrugedalje duke ringritur punimet horizontale dhe oxhaqet lidhes qe sherbejne per transport, ajrim e rrugedalje te dyta. Njekohesisht do te behet azhurnimi i punimeve hap pas hapi per te konkluduar ku do te fillohet shfrytezimi ne cilin bllok, pjese te bllokut apo celik.

Per hapjen pergatitjen dhe shfrytezimin e panelit +535-+570 parashikohen te kryhen punimete si ne tabelen e meposhteme:

Tabela Nr. 1- Punimet Minerale te nevojshme

Nr	Emertimi	Njesai	Horizontale	Pjerrta +vertikal
1	Horizonti 550m	ml	28	
2	Dhoma e arganellos +550	ml	4	
3	Dishenderi 550-535	ml		40
4	Horizonti 535m	ml	100	35
5	Horizonti 510m	ml	35	90
Shuma ml			167	165

Paraprakisht ne panelin 535 -570 jane parashikuar te kryhen rreth kete panel do te kryhen rreth 180 ml punime minerare, traversa e oxhaqe qe do te sherbejne per pergatitjen e shfrytezimin e rezervave te mineralit ne kete panel.

Shfrytezimi do te filloje nga lart poshte duke perdorur si horizont transporti galerine +535 Gjatesia e vogel ne shtrirje (Shiko projektionin vertikal) ben qe te jete vetem nje bllok ne shfrytezim i cili do te shfrytezohet nga kufiri.

Tabela Nr 2- Grafiku i kryerjes se Punimeve

Nr	Emertimi i punimit	Njesia	Sasia totale		V i t e t					
					I		II		III	
			Horizontale	Pjerrta +vertikal	horizontale	Pjerrta +vertikale	horizontale	Pjerrta +vertikal	horizontale	Pjerrta +vertikal
1	Horizonti 550m	ml	28		28					
2	Dhoma e arganellos +550	ml	4		4					
3	Dishenderi 550-535	ml		40		40				
4	Horizonti 535m	ml	100	35	40		40	35	20	
5	Dishenderi 535-510			65				30		35
6	Horizonti 510m	ml	35	25					35	25
Shuma ml			167	165	72	40	40	65	55	60

4.2 Lendet e para qe do te perdoren

- Karburanti (per venien ne pune te makinerive te transportit dhe atyre teknologjike gjate kohes se ngritjes se kantierit edhe operimit)
- Energjia elektrike (per venien ne pune te makinerive gjate periudhes se ngritjes se kantierit, ndricim edhe gjat procesit te punes per nxjerrjen e mineralit)
- Uji (uje per perpunimin e materialeve gjate kohes se ndertimit qe sigurohet nga me ane te pomave ose autobotave)
- Lende ndihmese jane betonet per sistemimin e kanalit te rrjedhjes se se ujit, mure mbrojtese per siguri teknike edhe per mbylljen e galerise. Ajer i kompreuar qe do te perdoret per cekicin per shim me ane te nje kopresori me 10 m³/ min.
- Produkti perfundimtar eshte nxjerrja e kromit

4.3 Aktivitete te tjera qe kerkon projekti

Ajer i kompresuar qe do te perdoret per furnizimin e cekicit pneumatik per shpim. Nje sasi prej 10 m³/ min eshte i mjaftueshem, cka do te sigurohet me ane te nje kompresori.

4.4 Produkti

Prodhim i mineralit te kromit me nje sasi prej 2 500 ton/vit e cila pas seleksionimit do te dergohet ne portin e Durrësit si per tregun vendas por edhe per eksport. Shfrytezimi i kesaj miniere do te jete prej 3 vitesh.

5. TE DHENA PER INFRASTRUKTUREN, FURNIZIMIN ME UJE, SHKARKIMET E UJRAVE DHE MBETJEVE, RRUGET EKZISTUESE DHE HAPJA E RRUGEVE TE REJA.

5.1 Furnizimi me uje

Furnizimi me uje do te behet ne rrjetin e zones edhe me ane te nje pompe e cila do te dergoje ujin en nje depozite e cila do te vendoset ne piken me te larte te minieres ku me pas do te rrjedhe me gravitet (rrjedhe te lire). Ne kete meyre behet e mundur edhe kursimi i energjise.

5.2 Furnizim me energji elektrike

Lidhja me rrjetin elektrik do te behet me ane te rrjetit elektrik te zones. Prane minieres ndodhet nje gabine elektrike qe furnizon fshatin, ku do te behet edhe lidhja elektrike qe do te perodret per nevojate puneese ne miniere qe jane perdorimi i kompresorit, per zyrat, ndricim, pomppimin e ujit edhe ventilim te ajrit. Linja elektrike qe synohet te ndertohet ehte 320 m nga gabina deri te miniera.



Figura 17- Pamje e gabines elektrike

5.3 Rruget ekzistuese dhe rruget e reja

Do te behet rikonstruksioni i rruges egzistuese qe fillon nga rruga automobilistike Librazhd-Prrenjas (ura e Bushtrices) deri ne miniere me nje gjatesi afersisht 4.2 km. Gjithashtu do te hapet edhe nje rruge 90 ml per akces me te qendrueshem ne miniere. Vlera e ketyre investimeve eshte parashikuar 470 000 leke.

5.4 Shkarkimet e aluvjoneve

Shkarkime te ujrave te ndotura nuk ka nga ky prces pune. Gjate punimeve ne miniere, ne raste te vecanta nese do te kete shkarkim te ujrave qe dalin nga proceset e pune, keto ujrave do te pompohen edhe to te dergohen ne vendet e trajtimit te ujrave, ose perpara se te derdhen ne lum do te behet nje paratrajtim i tyre. Ndersa per nevojat personale do te vendosen tualete portative edhe me grope septike.

6. PROGRAMIN PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN E NDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR PËR FUNKSIONIMIN E PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE, SIPAS RASTIT, EDHE FAZËN E PLANIFIKUAR TË REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES, PAS MBARIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT

6.1 Kohezgjatja e ndertimit dhe operimit

Vazhdimi I punimeve te projektit do filloje menjehere pas sigurimit te lejeve ne baze te legjislacionit ne fuqi, ku nje nder to eshte dhe leja mjedisore. Sipas vendimit te Ministrise se Infrastrukture edhe Energjise, shfrytezimi i kesaj miniere do te jete me nje afat kohor prej 3 vitesh nga data e fillimit te

punimeve. Pas shfrytezimit te mineralit te kromit do te behet edhe mbyllja e minieres sipas planit te menaxhimit te mjedist.

6.2 Pershkrimi flores edhe fanues

- **Flora**

Pellgu i perroit e Bushtrices ku ndodhet edhe Miniera Skroske karakterizohet në përgjithësi nga një relief tipik Kodrinoro-Malor— në pjesën e sipërme dhe të mesme. Pak a shumë forma masive malore e këtij pellgu është e thepisur ne forme V, ku shpatet ngrihen butë në pjesën fundore dhe pjerrësia vjen më e vogël. Kuotat ku ndodhet Miniera jane midis 500 m mnd dhe 700 m mnd.

Kryesisht mbizoterohet nga brezi i shkurreve ku pershihet shkoza dhe mbretja, dellinja. Ne kodrinat perrrth gjendet dushku. Ndersa pergjate shtratit te perroit pothuajse nuk ka vegjetacion pasi shpati eshte shum i thepisur dhe me shkembinj, cka ben qe mo te kemi vegjetacion ne kete pjese te perroit. Ndersa ne anen e djathte vetegjacioni eshte me i dukshem, ku pjeserisht eshte drollonje edhe dushk jo i dendur. Ne kodrat ne pikat me te larta gjendet kodra te mbuluara me pishe.



Foto 18- Foto nga zona e minieres



Figura 19- Foto nga vendodhja e projektit ne lumin e Bushtrices

Ndersa ne fillim te rruges ruese (ura e Bushtrices) 4.2 km larg nga miniera kemi shfaqen e shelgut, plepit edhe rrapit. Gjithashtu edhe bimesia eshte me e dendur pasi eshte zone me pjerrsi me te vogel edhe lugine me e gjera, ku vegetacioni eshte i pranishem.



Figura 20- Ura e Bushtrices (Bashkimi i lumit te Bushtrices me ate Shkumbin)

Bimësia që preket nuk kanë ndonjë funksion të vecantë, zona që do të preket do të rehabilitohet sipas kushteve të projektit, ku do të behet me e detajuar në planin e rehabilitimit të mjedisit. Duhet të theksojmë që të gjitha punimet do të kryhen në gjurmën egzistuese të projektit, ku kjo miniere ka qenë e shfrytëzuar me pare, dhe demet në mjedis do të jenë të minimizuara. Gjithashtu do të mbahen kontakte me drejtorinë rajonale të administrimit të pyjeve Elbasan.

- **Fauna**

Zona, për shkak të kushteve të veçanta të regjimit atmosferik, klimatik e gjeologjik, është e pasur në bimësi dhe në faunë. Fauna dhe flora formojnë një sistem ekologjik tepër kreativ dhe me vlera mjedisore. Fauna është karakteristike e faunës që jeton në zonën e pyjeve të dushkut, dhe bimëve të tjera gjethëgjenese. Zona ka edhe faunë të egër të larmishme, por si kudo në vendin tonë ajo është dëmtuar shumë nga gjuetia pa kriter depërtimi i njeriut, nga përdorimi i kimikateve, zjarret etj. Ndër llojet e botës shtazore përmendim kafshët tipike si derri i egër (sus Skrofa), që tani gjendet shumë rrallë. Në zonë mund të gjenden edhe ujku (Canis Lupus), lepuri (Lepus Europeus), kunadhja (Martes Foina), dhelpra (Vulpus-Vulpus), bagetia e imët etj. Kafshet shtëpiake si Lopa, delja, dhia ku një pjesë e njerzve të zones janë punesuar dhe i përdorin për nevojat e tyre si edhe për të tregtuar qumeshtin dhe neproduktet e tij.

Zona është e pasur me shpendë të tilla si thëllëza e malit (Perdix-Perdix), bufi, dallandyshja, harabeli, pëllumbi, e shumë e shumë shpendë dhe kafshë të egra etj. Ligji për mbrojtjen e mjedisit, vecanësisht ligji Nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë”, ndalon gjuetinë për 5 vite, ka shtuar faunën e egër në këto zone, duke shtuar një vlerë të vecantë.

Ndër llojet e peshqëve që rriten në këto pellg ujembledhes janë Mlyshi- I takon familjes së krapit (ciprinide). Mund të rritet ndonëse ralle edhe deri në 4-5 kilogram, mirepo llojet prej 2 kilogramesh gjenden më shpesh të varura për grepin e peshkatarit dhe konsiderohen si një gjah që vlen të peshkohet. Është shumë përhapur në ujërat fushore mirepo gjendet edhe në ujërat e lartësive. Edhe mlyshi, përderisa është më i ri, jeton në grupe, të cilat udhëhiqen nga peshqit më të mëdhenj. Trofa është peshk i ujërave të ëmbla që jeton në shumicën e lumenjve Shqipërisë. Troftat gjenden kryesisht në ujëra të ftohta e të kthjellëta, të temperaturave prej 10–16 °C. Sardelja është peshk karakteristik i këtij pelgu gjithashtu. Ai shumohet në maste të madhe dhe ka një gjatësi 10-15 cm. Gjatë vërtetimeve në terren nuk është vërejtur peshq perroi e Bushtrices për vetë faktin se përjetësia e perroit është e madhe dhe nuk bën të mundur një ekosistem të pershtatshëm për rritjen e peshqëve.

6.3 Pershkrim i ndikimeve në mjedis

Cdo aktivitet njëzëz mbi mjedisin natyror shkakton ndikime të ndryshme mbi të, i cili mund të jetë i vogël ose i madh, mund të jenë pozitiv apo negativ, i drejt për drejt apo i terthorë. Për të vlerësuar karakterin e ndikimit, të përmasave dhe faktorët e mjedisit mbi të cilët ushtrohen ndikimet është e nevojshme hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimeve Mjedisore (VNM). Objektivi kryesor i VNM është që vlerësimi i cdo aktiviteti njëzëz mbi mjedis të arrihet pas një studimi të thelluar i cili ka patur si qëllim kryesor menaxhimin sa më të mirë të burimeve natyrore. Ndikimet që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të burimeve natyrore të shmangen nëse është e mundur dhe nëse jo, niveli i ndikimit mbi mjedis të jetë i ulët.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor përmban në themelin e tij vlerësimin e ndikimeve mbi mjedis dhe në jetën sociale.

- Ndikim eshte termi i cili nenkupton cdo ndryshim, negativ ose pozitiv i cili ushtrohet mbi karakteristikat e mjedisit (Jacob etal. 2008).
- Vlersimi i ndikimit perkufizohet si procesi i analizes te parashikimit dhe vleresimit te ndikimit, i cili mund te lind nga cdo lloj aktiviteti njerzor para se ai te ushtrohet mbi mjedis (Jacob et al. 2008).

Ne referancat e ndryshme shpesh here pershkruhen perkufizime te ndryshme se cfare eshte nje Raport Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (EIA: Environmental Impact Assessment), por te gjitha kane si objektiv mbrojtjen e mjedisit.

Vlersimi dhe masat zbutese te ndikimeve qe lindin gjate fazes ndertimore dhe operale te nje projekti mbi mjedis, jane pikat me te rendesishme ne VNM, sepse ne ne kete menyre shmangen rreziket dhe ndotjet qe mund te ndodhin ne mjedis. Gjithashtu VNM duhet te promovojte shfrytezimin e burimeve natyrore ne menyre te qendrushme (sustainable use).

VNM jep mundesine e hartimit te nje katalogu para zbatimit te projektit me ndikimet e mundeshme qe mund te shkaktohen nga projekti. Propozon masa parandaluese ne raste kur evidentohen ndikimet. Per kete arsye, nje VNM hartohet para cdo projekti dhe shqyrtimi i mire i saj con ne marrjen e vendimeve te sakta dhe gjithashtu sherben per zgjedhjen e alternativave me te mira dhe me miqesore me mjedisin.

Hartimi i nje VNM nuk eshte nje proces i thjeshte edhe i lehte, sepse cdo lloj projekti eshte i vecante dhe mjedisi ku do te operohet per te marre jete projektet e ndryshme eshte i ndryshem dhe cdo lidhje projekt-mjedis con ne nje rast unik te lidhjes shkak-perfundim. Nese ne vend te VNM do te shqyrtohej dhe do te analizohej kosto-perfitim nuk do te merreshin parasysh ndikimet e mundeshme ne mjedis. Prandaj objektivi kryesor i VNM eshte analizimi i hollesishem i te gjithave llojeve te ndikimeve ne mjedis dhe propozimi i zgjedhjes se alternatives me te mire qe ofron projekti.

Hartimi i ketij studimi Vleresimor Mjedisor dhe Social eshte bere ne perputhje me ligjin nr. 10 440, datë 7.7. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis". Nje metode vleresimi duhet te percaktoje te gjitha ndikimet te cilat lindin drejt per drejte apo ne menyre te terthorte nga ndertimi apo nga operimi i projektit dhe gjithashtu duhet te percaktoje ne cilen faze te projektit lindin dhe cila eshte kohezgjatja e tyre. Percaktimi i ndikimeve u realizua nga nje hulumtim i mire i projektit teknik dhe parashikimi i ndikimeve te mundeshme qe lindin gjate fazave te ndryshme te tij ne mjedis.

Per vleresimin e ndikimeve mjedisore te cilat parashikohne gjate zbatimit dhe operimit te projektit eshte pare e arsyeshme qe karakteristikat mjedisore te klasifikohen ne tre kategori:

- a) Indikatorët abiotike
- b) Indikatorët biotike
- g) Indikatorët social/ekonomik

Grupimi i faktoreve mjedisore ndihmon ne nxjerrjen e shpejte te nje konkluzioni per gjendjen e mundeshme te mjedisit, ndihmon ne ekzaminimin e problematikes duke mos humbur kohe dhe mbi te gjitha jep mundesine e krahasimit me ndikimet e te njejtës natyre ne VNM. Ne tabelen e meposhtme paraqitet klasifikimi i faktoreve mjedisore te cilet mund te ndryshojne ne lidhje me fazat e projektit. Ne vazhdimesi te VNM vleresohen te gjitha parametrat e poshtepemendura




Figura 15- Indikatorët mjedisor

Megjithese cdo aktivitet i cfar do natyre qofte karakterizohet nga disa efekte mjedisore negative apo pozitive te cilat sipas natyres mund te jene afatshkurtra ose/dhe afatgjata, te minimizueshme ose te eliminueshme. Evidentimi i tyre dhe marrja ne konsiderate gjate aktivitetit te ndikimit ne mjedis eshte parakusht per nje parneritet ne mbrojtjen e mjedisit.

Duhet te theksojme se shumica dermuese e punimeve pergatitore qe perfshin ky projekt jane kryer shume vite me pare e per pasoje ndryshimet nga kjo faze tashme jane pershtatur me mjedisin dhe jane bere pjese e tije si nje habitat i vetem.

- **Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në tokë**

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Shqetësim i shtresës së tokës për shkak të hapjes së karrieres, punimittë hapjes dhe gjysmë transheve	Krijim i hinkave ne sipërfaqe dhe ulje e sipërfaqes se tokes. Kjo sasi dheu mund të sistemohet përgjatë hapjes minieres dhe të përdorët në fazën e fundit për qëllime rehabilitimi
Shqetësim i nentokes per shkak te terheqjes se mineralit te kromit gjate shfrytezimit.	Krijim te hapsirave nentoksore. Ne sistemin e shfrytezimit parashikohet qe nje pjese e tyre dhe te rimbushet me sterile.
Lëvizje e mjeteve të punës dhe automjeteve të transportit si kamione fadroma etj, mbi sipërfaqen e tokës krijojnë ngjeshje te saja.	Ngjeshja e tokës nga lëvizja e automjeteve dhe mjeteve gjatë punimeve të rikonstruksionit dhe atyre të reja do të limitohet brenda sipërfaqes së kërkuar
Erozion minimal ne kohe me rreshje ne sipërfaqen ku do të hapet kariera	Largim i grimcave të tokes që ekspozohen ndaj agjenteve atmosferike duke u shkeputur dhe levizur kryesisht drejt trupave ujore si perrenjte dhe prroskat ne afersi te objektit
Avari teknike, derdhje e karburanteve dhe lubrifikantëve.	Ndotje e tokes si pasoje e rrjedhjes se lubrifikanteve dhe karburanteve po per shkak te vellimit jo te madh te punimeve dhe numrit te reduktuar te makinerive, ndotja do te jete ne sasi te vogla
Gërmime për shkak të hapjes së gjysmë transheve nga makinerite	Vibrim i tokës, por gjykuar nga volumi i punimeve do te jete nje vibracion normal teknologjik vetem ne nje zone te ngushte te objektit
Nga punët me lëndë plasëse në sipërfaqe dhe nëntokë	Shkriftim i shkëmbit mëmë dhe mineralit si dhe vibrim i zonës rreth ku bëhen punët e shpim plasjes.

- **Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në ajër**

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet	Ndotje e ajrit. Sasia e gazeve NO2 dhe SO2 qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara
Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes	Ndotje akustike nga mjetet e punës për bërjen e birave dhe për ngarkim transport të mineralit. Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te

	krijone probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe dhe nje pjese e tyre do te kryhen nentoke
Krijimin e sasive të pluhurit si pasoje e qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit	Ndotje ajri. Ky fenomen do te jete me I dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesojë kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle
Sasira minimale pluhuri nga cekicet pneumatike per birat e shpim –plasjes.	Lagje e vazhdushme e frontit te punes dhe vendosja e shpimit te lagur.

- **Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në uje**

Teknologjia shfrytezimit te objektit parashikon perdorimin e ujit per shpimin e lagur dhe sperkatjen e stoqeve. Ujrat e reshjeve do te dekantohen ne gropa brenda zones se shfrytezimit. Rrjedhja e me tejshme e tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre me ane te nje kanali ne ane te rruges se hapjes deri ne kanalin e rruges se poshtme. Meqenese terreni eshte i thepisur nuk kemi grumbullim te ujrave nentokesore, cka aktiviteti yne nuk do te ndikojë ne ndotjen e tyre. Nese gjate punimeve do te ndodhi ndonje aksident edhe kemi ndikim te ujrave ato do te pompohen edhe do te depozitohen ne rezervuare te vecanta ku me pas do te dekantojne per tu pastruar.

- **Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në biodiversitet**

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Ndërhyrje në habitatet ne zone , shqetesim i faunes.	Siperfaqja ku janë kryher punimet eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht, proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit, do te ushtrojne ndikimet e tyre ne boten e gjalle sidomos do te mbajne larg zones disa lloje shtazore.

- **Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në peisazh dhe relief**

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Ndikime ne pejsazh dhe topografine e terrenit ku ndodhet objekti si rrezultat i karierës dhe depozitimit të sterilit të punime minerare	Nder ndikimet me evidente do te jene ndryshime i relievit dhe peisazhit, nga pjerrësia natyrale qe do te kene shkallët e karierës me lartësi 10 ml.. Stoqet e depozitimit të sterilit të punimeve minerare jane ekzistuese ato do të ndryshojnë gjithashtu relievin dhe peisazhin e vendik ku jan depozituar.

- **Mbetjet e ngurta**

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor	Ndotje urbane. Kartona, bidona vaji, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjesve
Minerali dhe sterili ne sasira te konsiderushme	Zenie e siperfaqes se tokes per stoqet e depozitimit te sterileve qe dalin nga kryerja e punimeve dhe sheshet e depozitimit te mineralit te prodhuar.

- **Ndikimet negative shtesë.**

Veprimtaria minerare nxjerrës e mineralit të kromit, është veprimtari e cila nuk shoqërohet me ndikime negative shtesë, në cilësinë e mjedisit rrethues të minierës e më gjërë. Ky aktivitet nuk ndikon negativisht gjere në sipërfaqen apo bimësinë e ulët deri në pemët e larta, pyjet. Ky aktivitet nuk ka shkarkime të ujrave të ndotur, gjithashtu nuk ka shkarkime në trupat ujqorë rreth minierës, lumenj, përrenj, rezervuarë, ujë mbledhës përfshi dhe burimet ujore.

Ndikimet sociale të projektit, të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet në mjedis të projektit (si zhurma, pluhuri, përdorimi i burimeve natyrore etj).

Ky projekt, nxjerrja e mineralit të kromit në minieren e Skroskes , shoqërohet me ndryshime të përdorimit të tokës aty ku është ndërtuar zona e miniera. Këto ndryshime nuk shoqërohen me ndikime negative të cilat të kenë ndikim negativ në jetën sociale. Ndikimet negative janë vetëm në reliev dhe në peisazh. Po ti analizojmë këto ndikime, ato nuk rezultojnë negative sepse janë ndryshime të pa shoqëruara me ndryshime të strukturës kryesore të tokës si dhe nuk shoqërohen me ndotje mjedisi apo me shkarkime të elementëve të dëmshëm për mjedisin.

Sterilet janë pjesë përbërëse e shkëmbinjve që formojnë zonën dhe relievin. Ndërkohë po të rendisim ndikimet pozitive të këtij aktiviteti (shfrytëzim të burimeve minerare për interes të njerëzimit, rritje e mrëqënijes së punonjësve, reduktim i papunësisë në zonë, kualifikim i mëtejshëm i puntorve, si dhe vend ndodhjen e minierës në një zonë shumë larg qendrave të banuara, sipërfaqen e vogël të shesheve, etj) dhe ti balancojmë me ndikimet negative vërejmë se ndikimet negative nuk përbëjnë problem. Gjithashtu është edhe permirsimi i infrastruktures se zones.

6.4 Masat zbutese per ndikimet ne mjedis

Në hapjen dhe shfrytëzimin e karrierës dhe minierës, është marë në konsideratë mbrojtja e mjedisit dhe standartet mjedisore si dhe të aplikohen masa konkrete.

- **Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne toke.**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Shqëtesim i shtreses se tokes per shkak te hapjes se minieres dhe hapjes së shesheve.	Sasia e dheut sistemohet pergjate shpatit dhe do te perdoret per qellime rehabilitimi ne faza te ndryshme te shfrytezimit ose per rehabilitimin e rrugeve dhe siperfaqeve te demtuara ne perfundim te shfrytezimit te minieres
Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit si kamione etj.	Per parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes do te shfrytezohen vendet e caktuara
Erozion siperfaqesor ne mot me rreshje	Janë hapur kanalet e drenazhimit ne sipërfaqe, qe do te ndalim forcën geryese te ujrave te reshjeve, ndersa pergjate perimetrit te sheshit te depozitimit te mineralit dhe hyrjes ne nentoke, janë hapur kanale perimetrike kufizuese qe frenojne geryerjen dhe transportin e tokes sipas gradientit te pjerrtise nga ujrat siperfaqesore. Ne pjese te vecanta do te shihet mundesia e mbjelljeve te fidaneve pyjore te pershtatshem per zonen.
Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes	Makinerite e shfrytezimit dhe transportit kontrollohen per gjendjen e tyre teknike dhe nese konstatohen pjese te amortizuara qe mund te rrjedhin lubrikante zevendesohen me te reja. Ne rast te ndonje aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale te lendeve ndotese ne mjedis merren masa per pastrimin e menjehershme te tokes se ndotur e cila do te depozitohet ne nje kazan te posatshem metalik ose prej betoni per t'u trajtur me pas

- **Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne ajer**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Emetime te pluhurit, zhurmes, gazeve, aromave dhe vibracione	Manikerite mirembahen teknikisht qe zhurma e tyre te jete vetem ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato perdoren me eficence dhe te minimizohet koha gjate se ciles mbahen ndezur motoret. Skapamentot jane të kompletuara me filtrat e tyre teknologjike te kapjes se grimcave (skapamentot e makinerive kane nje jastek te posatshem per kete gje). Perdoret nafte me permbajtje te ulet sqfuri. Menjanohet renia e borive te automjeteve nga shoferet per te mos krijuar zhurme dhe stres të panevojshëm. Qarkullimi i kamioneve ne qendrat e banuara behet me shpejtesi te ulet gje qe shmang jo vetem aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.
Ndotja e ajrit si pasoje e qarkullimit te automjeteve brenda teritorit te minieres	Mjetet e transportit jane objekt i kolaudimeve periodike, gjithashtu ato jane objekt i kontrollit nga vete subjekti. Ne rastet kur ato emetojne gazra mbi normat e lejuara si rezultat i defekteve hiqen nga qarkullimi dhe riparohen.
Ndotja e ajrit si pasoje e punes me shpim -plasje	Ne keto raste behet lagia me uje perpara shpimit ne menyre qe te minimizohet sasia e pluhurit te gjeneruar. Perdoret kur eshte e mundur shpimi i lagur dhe punonjesit jane te paisur me maska. Ndersa ne zonat e banuara nuk do te kemi ndikime pasi miniera eshte larg tyre dhe shpimet behen ne miniere.

- **Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne uje**

Teknologjia shfrytezimit te objektit parashikon perdorimin e ujit per shpimin e lagur dhe sperkatjen e stoqeve. Ujrat e reshjeve do te dekantohen ne gropa brenda zones se shfrytezimit. Meqenese terreni eshte i thepisur nuk kemi grumbullim te ujrave nentokesore, cka aktiviteti yne nuk do te ndikojte ne ndotjen e tyre. Nese gjate punimeve do te ndodhi ndonje aksident edhe kemi ndikim te ujrave ato do te pompohen edhe do te depozitohen ne rezervuare te vecanta ku me pas do te dekantojne per tu pastruar. Gjithashtu do te behet mirembajtja periodike e kanaleve te kullimit qe mos te kemi ndikim ne ujra edhe errozion.

- **Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne biodiversitet**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Shqetesim i faunes se zone	Shfrytezimi i mineralit eshte domosdoshmeri por respektohet rigorozisht siperfaqja e lejes per nderhyrje .Punimet zhvillohen ne siperfaqe me kariere dhe nentoke me galeri te thelluara. Depozitimi i sterilite dhe mineralit te nxjerre depozitohen jashte ne siperfaqe. Prandaj behet shume kujdes dhe respektohen stoqet dhe sheshet e sterileve dhe te mineralit te trasheguara, ndersa mjetet dhe makinerite kontrollohen periodikisht.

- **Identifikimi i masave zbutese ne peisazh.**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Ndikime ne pejsazh dhe topografine e relievit, ne kariere dhe hyrje te galerive	Depozitimi i sterileve dhe mineralit ne siperfaqe demtojne siperfaqen e relievit. Keto siperfaqe do te rehabilitohen menjehere sapo te mbarojë shfrytezimi i karrierës.

- **Identifikimi i masave zbutese mbetjet e ngurta**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Depozitim i sasirave te konsiderushme te sterileve	Keto depozitime demtojne siperfaqen dhe relievin. Subjekti do te minimizojë sa me teper nxjerrjen jashte ne siperfaqe te sterileve pasi nje pjese te tyre(40%) do ti depozitohen ne hapsirat e nentokes te krijuar nga terheqja e mineralit.Keto siperfaqe jane objekt i rehabilitimit sapo te mbarojë shfrytezimi.
Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor	Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet grumbullohen në vende të posaçme. Ato transportohen drejt drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal.

6.4 Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

6.4.1 Sasise se gjenerimit te mbetjeve

Bazuar ne ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” si dhe VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, ku volume I mbetjeve te ngurta do te trajtohet sipas legjislacionit ne fuqi. Nuk parashikohet nje volum I madh te mbetje te ngurta, ku kryesisht jane sterilet qe perbejne terrenin ne vetvete, ku referuar territorit te zones, jane Shkembinj me permbajtje Kromi, te cilat do te sistemohen ne vendet ku do te eperaktohen se bashku me pushtetin Lokal te zones por edhe me Agjencie Rajonale te Mjedisit Elbasan.

Referuar VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, mbetjet e gjeneruara i klasifikohen sipas pikve:

Pika 13 Mbetje vajrash dhe mbetje te karburanteve te Lëngshme

1301- Mbetje te vajrave hidraulike

1302- Mbetje vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikante

Pika 16 Mbetje te pa specifikuara

16 01 03- Goma jashtë përdorimi

Pika 17. Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara)

1701- Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika

1702- Dru, qelqe dhe plastika

1705- Dhera

Pika 20 Mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje Industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë Fraksionet e mbledhura veçmas

20 01 01- Letër dhe karton

20 03 03- Mbetje nga pastrimi i rrugeve

20 03 04- Llumra nga gropat septike

20 01 08- Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat

Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet fiziko - kimike të mineraleve

01 01 01 Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve metalore

01 03 08 Mbetje pluhurash, përveç atyre të përmendura në rubrikën 01 03 07; 01 03 09

01 04 13 Mbetje që vijnë nga prerja dhe sharrimi i gurëve, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07; 01 04 99

6.4.2 Trajtimi i mbetjeve

Mbetjet inerte te gjenaruara do te trajtohen sipas VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, eshte vete gjeneruesi (ne kete rast subjekti Elbesa sh.p.k) i cili do te largoje/transportoje mbetjet e gjeneruara ne landfillet inerte te percaktuara nga Bashkia/ Njesia e Qeverisjes Vendore.

Mbetje vajrash dhe mbetje te karburanteve te lëngshme, qe klasifikohen si mbetje te rrezikeshme do te trajtohen sipas VKM Nr. 765 date 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”, Kreu IV ne piken 6 ku citohet: Kur krijuesi i VP-ve është person që ka në përdorim vetjak automjete dhe kur ndërrimin e vajit e bën vetë, vajin e përdorur e depoziton në enë të veçanta dhe e dorëzon te subjekti që është pajisur me licencën III.2.B, për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e VP-ve.

Mbetjet e biodegradueshme qe do te gjenerohen ose mbetjet e gjelberta qe ketu futet druri, ku bejne pjese pemet qe do te priten apo zhvendosen nga zhvillimi I aktivitetit, gjithashtu edhe mbetjet nga pastrami i rrigeve qe mund te jete krahsitja, do te trajtohen sipas VKM nr. 608, datë 17.9.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”. Sugjerohet qe mbetjet e drurit te perdoren per dru zjarri per banoret e zones, pork jo me pare duhet te percaktohet nga njesia e qeverisjes vendore per destinacionin e tyre.

Mbetjet nga gomat e perdorura te automjeteve do te trajtohen sipas VKM nr. 652, datë 14.9.2016 “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura” ku ne piken 5 citohet: Zotëruesi (ne kete rast subjekti **Elbesa sh.p.k**) i gomave të përdorura i dorëzon pa pagesë gomat e përdorura te grumbulluesi dhe/ose te magazinuesi dhe/ose te trajtuesi i gomave të përdorura. Në rastin e zëvendësimit të gomave të përdorura me goma të reja në pikat e servisit, zotëruesi i gomave të përdorura i dorëzon ato te servisi.

Mbetjet e urbane te riciklueshme ne kete rast futen kartoni, qelqi dhe plastika qe do te gjenrohen do te trajtohen sipas Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar. Ne kantierin e punes do te vendosen 3 kosha ku do te vendosen ne kantierin e punes dhe do te zbrazen ne frokuence ditore.



Figura 21- Sistemi i menaxhimit te mbetjeve ne kantierin e ndertimit

- Ngjyra:Jeshile (Organike)
- Verdhe:Plastike /qelq

- Blu:(Letër & Karton)

Keto mbetje do te dergohen ne vendin e grumbullimi te percaktuar nga Bashkia/ Njesia e Qeverisjes Vendore, pasi klasifikohen ne mbetje urbane.

Llumrat nga gropat septike do te trajtohen sipas Vkm nr. 127, datë 11.2.2015 “Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura” ne kreun I pika dh citohet: “Impiant individual ose lokal trajtimi i ujërave të ndotura” është gropa septike, gropa e ujërave të zeza, gropa e banjave, banja në oborr me gropë ose drenazhi francez, i cili shërben për trajtimin në vend të ujërave të ndotura, në zonat ku nuk ka sistem publik kanalizimesh;

Sugjerohet qe ne kantierin e punes te perdoren tualeta portativ pasi jane te levisshem dhe puna do jete ne disa fronte.



Figura 22- Shembull i nje tualeti portativ

6.4.3 Transportimi i mbetjeve

Transportimi i mbetjeve do te behet nga persona te autorizuar me licence te tipit III.2.B si detyrim i ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar.

6.4.4 Asgjesimi i mbetjeve

Materiali qe do te depozitohet eshte kryesisht materiali me perberje shkembore, aluvione te cimentuara, si dhe materialet me perberje guresh te cilat do te depozitohen me vete dhe do te perdoren si mbulesa e ketyre vend-depozitimi ne menyre qe me kalimin e kohes vegjetacioni ne keto zona mund te zhvillohet. Gjithashtu i gjithe materiali qe do te depozitohet do ngjishet, dhe neqoftese eshte e nevojshme do te krijohen te gjitha kanalet drenazhuese perreth venddepozitimit ne menyre qe ujerat siperfaqesore te mos pengohen nga rrjedhja e tyre. Projektimi i ketyre vend-depozitimeve do te behet ne menyre te tille ku jane evituar te gjitha konfliktet me objektet qe ndodhen ne kete zone, duke iu shmangur edhe zonave te banuara ne menyre qe te eliminohen edhe rrisqet me te vogla nga prania e ketyre venddepozitimi.

Gjithashtu per te ruajtur keto depozitime nga erozioni apo shkarjet do te behet nje ngjeshje e mire e saj per te shmangur fundosje te ketyre shtresave te tokes. Per te zvogeluar efektin e shpelarjeve te ketyre siperfaqeve nga rreshjet e shiut pjerresite e nevojshme me kanalet e hapura do te formohen ne siperfaqet e ketyre venddepozitemi.

Megjithese nuk paraqitet e nevojshme, por nqs do te jete e tille ne fund skarpatat e ketyre venddepozitimi mund te ndertohen mure mbajttese (Gabion) lokale me ane te materialit shkembor (Gure te Medhenj) ne menyre qe te evitohen rreshqitjet.

Shkarkimi i materialeve ne shesh-depozitim do te kryhet sipas nje radhe te caktuar qe do te thote, materialet do te shkarkohen me shtresa.

Kompania investitore parashikon qe te recikloje pjesen e materialit materialin e ngurte ne rruget e aksesit duke reduktuar koston e materialeve inerte nga lumenje edhe mbrojtjen e errozionit e zones. Nese do te kete materiale qe do te teprojne ato do te trajtohen sipas menyres se mesiperme dhe ne bashkepunim me institucionet lokale te zones.

7. LIDHJET E MUNDESHME TE PROJEKTIT ME PROJEKTE TE TJERA EKZISTUESE, PRANE ZONES SE PROJEKTIT

7.1 Lidhja e projektit me infrastrukturen e zones

Lidhja me infrastrukturen e zones eshte nepermjet rruges automobilistike Librazhd-Prrenjas ne vendin e quajtur ura e Bushtrices. Deri ne vendin e projektit eshte rruge rurale (e pasafaltuar) afer 4.2 km. Kjo rruge do te permirsohet edhe mirembahet nga kompania gjate proceseve te punes.

Projekti ne fjale eshte ne politikat e Shtetit Shqiptar, perkatesisht Ministrise se Infrastruktures edhe Energjise ne planin e saj per shfrytezimin 3-vjecar te minerave te cilat kane qene te shfrytezueshme edhe me pare. Nga studimet edhe vezhgimet ne keto miniera ka rezerva te tjera Kromi qe mund te shfrytezohen per nje afat te caktuar. Bazuar ne VKM nr.248, datë 02.05.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 347, datë 29.4.2011 të këshillit të ministrave "për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare", dhe Urdhrit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 107, datë 10.03.2014 "Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2014", i ndryshuar, eshte hape gara per marrjen pjese e kompanive per shfrytezimin e zonave minereare me numer: Nr. 165/4, Nr. 289/4, Nr. 516/7, Nr. 521/1, Nr. 367/7. Ne zonen minerare Nr. 516/7 Skroske, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan, kompania Elbesa sh.p.k eshte shpallur fituese per shfrytezimin e Minieralit te Kromit per nje periudhe 3 vjecare.

7.2 Alternativat e marra ne konsiderate per vendodhjen e projektit dhe teknologjise qe do te perdoret

Duke pasur parasysh dhe shqyrtuar me kujdes :

- Pozicioni i trupit xeherore ne plan dhe prerje;
- Vendosjen e punimeve ekzistuese ne raport me trupin xeherore;
- Trashesine e trupit te hedhur ne keto galeri sipas dokumentimeve te kryera;
- Kendet e renies dhe zhytjes se trupave dhe lidhjes mes tyre.

Mendojme qe punimet e reja per shfrytezimin e mbetjeve teknologjike dhe te trupave mineral te pjeses mbi kuoten +560 dhe nuk do te duhet te hapen. Punime minerare te mirfillta do te hapen per shfrytezimin e rezervave mbi koten +535 dhe asj mbi kuoten +510m Ne keto kushte meqenese shpimet kane kapur trupin ne kuoten +535 nen kete kuote do te jente e nevojshme te kryhen punime shpimi nentokesore, ne se gjate kryerjes se punimeve te shfrytezimit te ketij paneli , nga sherbimi gjeologjik rezulton e nevojshme.

- Punimet do te kryhen gjithnje ne anen e shtruar per te evituar rrezikun qe mund te vije nga ndonje punim shfrytezimi apo punim minerar, por qe nuk eshte i hedhur ne dokumentacionin i cili eshte siguruar nga shoqeria ne rruge private. Kjo eshte edhe arsyeja qe punimet nuk jane saktuar pasi pas ringritjes se punimeve do te behet azhornimi i tyre topografik e gjeologjik.
- Paraprakisht mendohet se jane per tu ringritur 20-30% e volumit te pergjithshem te punimeve. Do te hapen traversa nga punimet ekzistuese te hapura vite me pare, por qe do te ringrihen me marrjen e kesaj leje. Keto traversa, do te sherbejne si traversa zbulimi per drejtimet qe mendojme se nuk eshte bere ky zbulim, por edhe si fronte pune nga do te vilet materiali i celiqeve qe jane lene me pare nga shfrytezimi

Objekti "Skroske" eshte hapuar dhe punimet minerare jane vendosur per nje menyre te caktuar shfrytezimi, qe eshte perdorur ne kete miniere, por ne pergjithesi edhe ne minierat e tjera te kromit te vendit tone. Kushtezuar nga pozicioni hapsinor i trupave te mineralizuar shfrytezimi do te jete nentokesor. Ne zgjedhjen e menyres se shfrytezimit ndikojne nje sere faktoresh te cilet do te merren ne konsiderate, qe me kryesoret jane:

- Menyra e pergatitjes se bllokut
- Shfrytezimi pa rrezik i trupit xeheror dhe kushte te mira ajrimi ne bllok
- Kushte te mira dhe siguri per levizjene njerezve, maqinerive e materialeve neper punim.
- Hubje minimale e mineralit ne celiqet qe sherbejne per te mbrojtur punimet pergatitore.
- Kushte te favorshme dhe rendiment te kenaqshem ne ngarkim e transport.
- Shpenzime minimale per mbajtjen e punimeve dhe mirembajtjen e armaturave.
- Drejtimit shfrytezimit do te jete shfrytezim nga lart-poshte, ndersa e bllokut nga kufir per ne gender.

Nga sa jemi informuar dhe nga fakti se per trupa te tille ne shfrytezim ne kete miniere eshte perdorur sistemi i shfrytezimit me galeri nenkati. Ky sistem rekomandohet edhe ne te ardhmen ku lartesia e katit do te jete ne vartesi te dimensioneve ne renie te trupave minerare, pasi sipas shkalles se njohjes se trupave ne kete vendburim ka luhate te medha dhe trashesi e trupave eshte e vogel. Lartesi e nenkatit do te jete 5-6-8 m, por gjithnje kjo do te gjykohet sipas situates konkrete. Lartesi kati per panelin +535-+570 do te jete 35m ndersa ndersa nen nivelin +510 do te jete 25m. Per pjesn nen kuoten +510m, ne varertesiti te rezervave qe eventualisht mund te zbulohen do te percaktohet ne nje faze te mevonshme me projekt qe do te hartohet nga drejtuesit e minieres. Kjo eshte e kushtezuar edhe nga ekzistenca e trupave te mineralit te cilat ne kete vendburim jane mjaft te coptuar nga tektonike dhe

te paqendrueshem ne trashesi. Per mbetjet e shfrytezimit do te hartohet pasaporte e veçante per shfrytezimi e secilit sipas kushteve specifike duke u realizuar gjithnje ne prezence te drejtuesit teknik.

- Gjatesia e bllokut 16-20-25m
- Lartesia e nenkatit 5-6-8m
- Largesia e hinkave te vjelejes se mineralit 4-6m.

Per rrezimin e mineralit do te perdoren bira me thellesi 2-2.5m. Birat do te behen me çekiçe shpues te zakonshem me mbajtese pneumatike, ne tavan te galerise se nenkatit. Marrja e bllokut, sipas rrethanave do te behet nga kufiri per ne qender mbasi blloku parashikhet te pergatitet me oxhak ne qendert te tij . Gjatesia e nenkatit eshte e vogel 15-18 m dhe oxhaku qendror ne profilin 2-2 e ndan ate ne dy pjese relativisht te shkurtra.

7.3 Perdorimi i lendeve te para gjate funksionimit (shfrytezimit) ,uje ,energji ,lende djegese dhe menyra e sigurimit te tyre

Lenda e pare qe do te perdoret eshte energjia elektrike, uje edhe nafta. Energjia elektrike kryesisht do te perdoret per ndricim, zyra edhe per kompresorin e ajrit. Gjashtu edhe per pompimin e ujit kur eshhte e nevojshme. Kur eshhte e nevojshme do te perdoren edhe ventilatore ajrimi ne minere cka frunizohen me energji elektrike. Energjia elektrike do te sigurohet nga gabina elektrike e fshatit qe ndodhet aty afer.

Uji do te perodret kryesisht ne procesin e perdorimit te cekisit pneumatik per te reduktura pluhurat. Gjithashtu edhe per nevojat e zyres edhe uje i pijshem. Sigurimi i ujit do te behet nga burimet e zones edhe me autobote ose me ane te vendosjes se nje pompe.

Lende djegese, nafta kryesisht do te perdoret per makinerit e ngarkim shkrakimit qe jane kamiona ose vinca per ngritjen edhe transportimin e mineralit. Nafta do te sigurihet me ane te nje boti qe do te furinizoje makinerite sipas nevojës se proceseve te punes. Nafta do te merret nga karburantet qe gjenden ne rrugen automobiliistike Librazhd-Prrrenjas.

7.4 Aktivitete te tjera qe nevojiten per zbatimin e projektit (ndertimi i kapanoneve apo rezidencave).

Aktiviteti tjetër është ngritja e kantierit të ndertimit para fillimit të punimeve si dhe përgatitja planit të organizimit ku do të shihen mundësitë që punimet të kryen në disa fronte, për të minimizuar kohën e ndertimit dhe shfrytezimit të projektit. Gjithashtu konsultimi me banorët e zonës në rast të ndonjë konflikti gjatë periudhës së ndertimit dhe shfrytezimit. Mbjtja kontakte me pushtetin lokal dhe ministrinë e linjes për çdo problem gjatë shfrytezimit të projektit të projektit.

8. INFORMACION PER LEJET ,AUTORIZIMET DHE LICENSAT ,SIPAS LEGJISLACIONIT NE FUQI,PER LEJIMIN,AUTORIZIMIN, LICENSIMIN E PROJEKTIT

Shoqëri Elbasa Sh.p.k është shpallur fituese për shfrytezimin e minierës së Kromit me Nr. 516/7 Skroske, Bashkia Prrrenjas, Qarku Elbasan për një periudhë 3 vjeçare me ane të shkresës datë 27.10.2020 Nr. Prot. 7572/1 nga ana e Ministrisë së Infrastrukturaes edhe Energjisë për aplikimin për leje Minerare të zonës në fjalë. Përveçse lejes Minerare, në bazë të legjislacionit në fuqi, kërkohet

edhe leje mjedisore per kete aktivitet, ku se pari duhet ti neshetrohet procedures se VNM-se se thelluar. Per procedurat e VNM-se se thelluar do te behet edhe nje konsultim me publikun e zones edhe aktoret lokal per te marre mendimet e tyre edhe sugjerimet ne lidhje me projektin qe do te zhvillohet.

9. KOPJE TE LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE LICENSIVE QE DISPONON ZHVILLUESI PER PROJEKTIN E PROPOZUAR , NE PERPUTHJE ME PERCAKTIMET E BERA NE LEGJISLACIONIN NE FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOPRETEENTE PER LEJIMIN/AUTORIZIMIN/LICENSIMIN E PROJEKTIT.

Bashkangjitur eshte shkresa per njoftimin e te drejtese se aplikimit per leje minerare nga ana e Ministrise se Infrastruktures edhe Energjise date 27.10.2020 Nr. Prot. 7572/1.

Expert Mjedisi. Kristaq GJOKA

Expert Mjedisi Yzeir MIRAKA

MSc. Ing. Mjedisi Bestar CEKREZI 

KONSULENTI:

ZENIT & CO SH.P.K.

ADMINISTRATORI

ARQILE PERI

INVESTITOR:

ELBESA SH.P.K

ADMINISTRATORI

BESNIK PISHA 



TIRANE, Janar 2021

PERSHKRIMI TEKNIK I VNM-se PER PROJEKTIN " SHFRYTEZIM I MINERALIT TE KROMIT SKROSKE ME NR.516/7 TE ZONES MINERARE " ne Qarkun e Elbasanit, Bashkia Prrenjas, Fshati Skroske



PERSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT U PERGATIT NGA GRUPI I PUNES I PERBERE NGA:

Expert Mjedisi. Kristaq GJOKA



Expert Mjedisi Yzeir MIRAKA



MSc. Ing. Mjedisi Bestar CEKREZI



KONSULENTI:

ZENIT & CO SH.P.K.

ADMINISTRATORI

ARQILE PERI



INVESTITOR:

ELBESA SH.P.K

ADMINISTRATORI

BESNIK PISHA



TIRANE, Janar 2021

(Azhornuar)

PERMBAJTJA

PERMBAJTJA.....	2
1. PARATHENIE	4
2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT	5
2.1 QELLIMI I PROJEKTIT	5
2.2 KUADRI LIGJOR	6
➤ KLASIFIKIMI I PROJEKTIT	9
2.3 VENDODHJA GJEOGRAFIKE E PROJEKTIT	10
2.4 VENDODHJA ADMINISTRATIVE	12
2.5 TOPOGRAFIA DHE MORFOLOGJIA.....	13
2.6 PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE KLIMATIKE.....	16
2.7 NDIKIMI NË HABITAT DHE OBJEKTET ME STATUS TË VENÇANTË.....	17
3. SKICAT DHE PLANIMETRIT KRYESORE TE PROJEKTIT	18
4. PERSHKRIMI I PROCESVEVE NDERTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE	23
4.1 HAPJA DHE SHFRYTEZIMI I VENDBURIMIT TE MINIERES.....	24
4.2 LENDET E PARA QE DO TE PERDOREN	26
4.3 AKTIVITETE TE TJERA QE KERKON PROJEKTI	26
4.4 PRODUKTI	26
5. TE DHENA PER INFRASTRUKTUREN,FURNIZIMIN ME UJE ,SHKARKIMET E UJRAVE DHE MBETJEVE,RRUGET EKZISTUESE DHE HAPJA E RRUGEVE TE REJA.....	26
5.1 FURNIZIMI ME UJE.....	26
FURNIZIMI ME UJE DO TE BEHET NE RRJETIN E ZONES EDHE ME ANE TE NJE POMPE E CILA DO TE DERGOJE UJIN EN NJE DEPOZITE E CILA DO TE VENDOSSET NE PIKEN ME TE LARTE TE MINIERES KU ME PAS DO TE RRJEDHE ME GRAVITET (RRJEDHE TE LIRE). NE KETE MEYRE BEHET E MUNDUR EDHE KURSIMI I ENERGJISE.....	26
5.2 FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE	26
5.3 RRUGET EKZISTUESE DHE RRUGET E REJA	27
5.4 SHKARKIMET E ALUVJONEVE.....	27
6. PROGRAMIN PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN E NDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR PËR FUNKSIONIMIN E PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE,	

SIPAS RASTIT, EDHE FAZËN E PLANIFIKUAR TË REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES, PAS MBARIMIT TË	
FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT	27
6.1 KOHEZGJATJA E NDERTIMIT DHE OPERIMIT	27
6.2 PERSHKRIMI FLORES EDHE FANUES.....	28
6.3 PERSHKRIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS	30
6.4 MASAT ZBUTESE PER NDIKIMET NE MJEDIS	36
6.4 MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA	39
6.4.1 Sasise se gjenerimit te mbetjeve	39
6.4.2 Trajtimi i mbetjeve.....	40
6.4.3 Transportimi i mbetjeve	41
6.4.4 Asgjesimi i mbetjeve	41
7. LIDHJET E MUNDESHME TE PROJEKTIT ME PROJEKTE TE TJERA EKZISTUESE, PRANE ZONES SE	
PROJEKTIT.....	42
7.1 LIDHJA E PROJEKTIT ME INFRASTRUKTUREN E ZONES	42
7.2 ALTERNATIVAT E MARRA NE KONSIDERATE PER VENDODHJEN E PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISE QE DO TE PERDORET	42
7.3 PERDORIMI I LENDEVE TE PARA GJATE FUNKSIONIMIT (SHFRYTEZIMIT) ,UJE ,ENERGJI ,LENDE DJEGESE DHE MENYRA E SIGURIMIT	
TE TYRE	44
7.4 AKTIVITETE TE TJERA QE NEVOJITEN PER ZBATIMIN E PROJEKTIT (NDERTIMI I KAPANONEVE APO REZIDENCEVE).....	44
8. INFORMACION PER LEJET ,AUTORIZIMET DHE LICENSAT ,SIPAS LEGJISLACIONIT NE FUQI,PER	
LEJIMIN,AUTORIZIMIN, LICENSIMIN E PROJEKTIT	44
9. KOPJE TE LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE LICENSAVE QE DISPONON ZHVILLUESI PER PROJEKTIN E	
PROPOZUAR , NE PERPUTHJE ME PERCAKTIMET E BERA NE LEGJISLACIONIN NE FUQI, SI DHE INSTITUCIONET	
KOPRETEnte PER LEJIMIN/AUTORIZIMIN/LICENSIMIN E PROJEKTIT.	45

1. PARATHENIE

Subjekti "ELBESA" shpk; është një shoqëri eksperience shume vjeçare ne shfrytezimin dhe perpunimin e mineralit te kromit e regjistruar ne vendin tonë NUIS K33219201C me adrese: Ish Kombinati Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan. Gjate aktivitetit te saj ajo ka akumuluar një eksperiencë shume vjeçare në fushën e këkim-zbulim- shfrytëzimit dhe tregetimit te mineraleve dhe ka mundësi financiare për realizimin e investimeve të parashikuara për kryerjen e aktivitetit minerar të shfrytëzimit të mineralit te kromit në objektin e kërkuar për marrjen e lejes mierare.

Zona minerare e cila do te shfrytezohet eshte Nr. 516/7 ne Bashkine Prrenjjas, fshati Skroske, ku Kompania ELBESA sh.p.k eshte shpallur fituese ne garen e tenderimit nga ana e Ministrise se Infrastrkutures edhe Energjise per shfrytezimin e kesaj zone minerare te kromit per nje periudhe 3-vjecare. Sasia e kromit qe do te nxirret nga kjo miniere eshte llogaritur 2500 ton/vit dhe vlera e investimit eshte parashikuar 8 600 000 leke per 3 vitete e shfrytezimit te Minieres. Vlera e perfituar nga ky aktivitet eshte parashikuar 30 250 000 leke. Siperfaqja qe do te shfrytezohet eshte 0.077 km2 ose 7.7 Ha.

Shrytëzimi do të bëhet me punime nentokesore, në perputhje me kërkesat e ligjit Nr 10304, date 15/07/2010 "Per Sektorin Minerar ne Republikën e Shqiperise", si dhe të të gjitha akteve nënligjore të dala në zbatim e për zbatim të tij.

Zona Nr 516/7, si dhe zonat e tjera konkruuese, është publikuar për procedure konkurimi sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", pikës 5 dhe pikave 7/7 e 7/8 të VKM nr. 320, datë 21.04.2011 "Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese", Urdhrit të Ministrit të Energjise dhe Industries, Nr 107, date 10.03.2014 "Për miratimin e Planit Vjetor Minerar 2014". Me ane te njoftimit Nr. Prot. 7572/1 nga ana e Ministrise se Infrastruktures edhe Energjise shoqeria ELBESA sh.p.k eshte shpallur fituese per shfrytezimin e kromit ne kete zone minerare.

Projekti ne fjale i neshtrohet procedures se VNM-se se thelluar bazuar ne Ligjin Nr. 10 440, datë 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" i ndyshuar, Neni 9, procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: projektet e listuara në shtojcën I; pika 19: Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Qellimi i Projektit

Qellimi i projektit eshte shfrytezimi i mineralit te kromit nga zona minerare Nr. 516/7 Skroske, prrenjas, Qarku i Elbasanit. Kompania ELBESA sh.p.k eshte shpallur fituese ne garen e tenderimit nga ana e Ministrise se Infrastruktures edhe Energjise per shfrytezimin e kesaj zone minerare te kromit per nje periudhe 3- vjecare. Sasia e kromit qe do te nxirret nga kjo miniere eshte llogaritur 2500 ton/vit dhe vlera e investimit eshte parashikuar 8 600 000 leke per 3 vitete e shfrytezimit te Minieres. Vlera e perfituar nga ky aktivitet eshte parashikuar 30 250 000 leke. Siperfaqe qe do te shfrytezohet eshte 0.077 km² ose 7.7 Ha. Sasia e kromit qe do te nxirret do te tregtohet ne tregun vendas edhe per eksport.

Ne objekt eshte kryer nje mori punimesh gjeologjike te kerkim-zbulimit te tipit kanale pastrime etj . Rezultatet e mara nga keto punime te kryer nga ish ndermarja minerare e kromit Perenjas si dhe dokumentimet e ndryshme, te kryera nga vete subjekti gjate kryerjes se punimeve te dokumentuese ne zonen e objektit , kane sherbyer si baze per hartimin e pjeses grafike dhe projektit te shfrytezimit te ketij objekti .

Miniera e kromit Skroske ka filluar shfrytezimin ne vitin 1988, mbi bazen e projekt idese te hartuar ne vitin 1987. Baze per hartimin e ketij projekti dhe fillimin e aktivitetit minerar, ne vendburimin e kromit Skroske ka qene relacioni gjeologjik i dhene nga Ndermarrja Gjeologjike Pogradec, Prrenjas, Librazhd me gjendje rezervash 01.03.1987 si me poshte:

- Rezerva te kategorise C1 - 67 292 tone
- Rezerve te kategorise C2- 16 567 tone
- Gjithsej C1+C2- 83 859 tone

Permbajtja mesatare e Cr₂O₃ ne bllok per vendburimin ka rezultuar 36-42%.

Per hartimin e ketij studimit tekniko-ekonomik dhe projektit te shfrytezimit te ketij objekti kromi jane mare ne konsiderate:

- Pozicioni gjeografik dhe mardheniet e objektit me qendrat e banuara, kryesisht me qytezen e Perenjasit, qe ndodhet rreth 7 km larg ne vije ajrore nga objekti, 16 km nga qyteti i Librazhdit (vije ajrore) edhe 4.2 km nga ura e Bushtrices (rruga automobilistike).
- Kushtet e pergjitheshme si dhe topografia dhe klima e zones, ne te cilen ndodhet objekti i qe parashikohet ti nenshtrohet shfrytezimit;
- Hidrologjia, hidrogjeologjia dhe hidrografia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit;
- Gjendja, ne pergjithesi e infrastruktures se rajonit dhe te zones se objektit, mundesite e permiresimit te saj, ndertime dhe instalime te tjera te domosdoshme per shfrytezimin e objektit nga pikpamja minerare;
- Materiali gjeologjik baze lidhur me ndertimin gjeologjik te rajonit dhe vendburimit, sasine dhe cilesine e rezervave gjeologjike dhe te shfrytezueshme brenda kufijve te percaktuar te shfrytezimit si dhe eksperiencen e aktivitetit minerar ne kete miniere;
- Eksperiencen e grumbulluar gjate kryerjes, nga ish Ndermarrja Gjeologjike e Pogradecit, Prrenjasit dhe Librazhdit dhe te ish Minieres se kromit Skroske, asaj te Bushtrices dhe Katjelit, te punimeve gjeologjike, qe lidhen kerkim zbulimin e ketij vendburimi dhe kryesisht te dhenat lidhur me

- qendrusherme e shkembinjve qe ndertojne objektin si dhe te trupave xeherore te konkretizuar ne te si dhe punimeve te ndryshme minerare te pergatitjes dhe shfrytezimit;
- Hidrogeologjia e objektit dhe raporti me ujrat nentokesore dhe siperfaqesore si dhe ato te shtratit te lumit te Bushtrices
 - Sasite e rezervave ne trupat e objektit qe do te merren ne konsiderate elementete shtruarjes, rezervat. pametrat gjeometrike dhe thellesine ndodhjes se rezervave
 - Punimet minerare gjeologo-zbuluese dhe ato te pergatitjes e shfrytezimi te hapura, gjendja e tyre dhe mundesia e riperdorimit te tyre;
 - Nevojat per kryerjen e punimeve te ndryshme te reja per hapjen, pergatitjen dhe shfrytezimin e objektit;
 - Kerkesat e ndryshme per makineri, pajisje, instalime dhe investime te tjera per pergatitjen dhe shfrytezimin e objektit;
 - Llojet e produkteve te prodhuara ne sasi dhe cilesi, trajtimi i tyre si dhe tregu i shitjes se tyre dhe çmimet;

Objekti perfshihet ne nje vendburim kromi ne te cilin eshte shfrytezuar mineral kromi ne zone e perfshire midis galerive te hapura te ish minieres midis kuotave +510 deri +545 Vendburimi eshte shfrytezuar pjeserisht ne pjesen e siperme nga vitet 2018-2019 dhe eshte braktisur ne vitin 2019, pas perfundimit te shfrytezimit te rezervave te objektit ne pjesen e siperme te tyre.

Nga kjo kohe, galerite e hapura si dhe furnelet qe kane sherbyer per te pergatiturr rezervat jane braktisur dhe nuk jane aktivizuar me. Ne projekt parashikohet te shfrytezohen rezervat e mbetura te trupit, ne pjeset me te poshteme si dhe mbetjet e tjera teknologjike (tanike), te cilat gjate ketyre viteve nuk jane shfrytezuar.

2.2 Kuadri ligjor

Qëllimi i VNM-së është të vlerësojë ndikimet negative dhe pozitive të projektit si dhe të paraqesë masat që duhet të aplikojë kompania për reduktimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis dhe komunitet.

- **Objektivat e VNM-së**

Objektivi kryesorë i raportit të VNM-së është që të përmbushë kërkesat e legjislacionit shqiptar, me qëllim që të kemi një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor. Objektivat specifike të VNM-së janë:

- Të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e rëndësishme mjedisore nga zhvillimi i projektit
- Për të përcaktuar përpuethshmërinë e projektit të propozuar me përdorimin e tokës dhe të
- Vlerësojë kushtet lokale mjedisore
- Për të parë avantazhet nga zbatimi i këtij projekti
- Për të vlerësuar dhe zgjedhur alternativën më të mirë nga opsionet e mara në studim
- Të përfshijë planet e menaxhimit Mjedisorë dhe mekanizmat monitoruese gjatë fazave të
- zbatimit dhe funksionimit të projektit.

➤ **Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin**

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekti i propozuar. Ky raport i Vlerësimit të ndikimit në Mjedis është hartuar duke patur parasysh legjislationin e shtetit shqiptar dhe të Komunitetit Europian, me akte juridike ligjore dhe nënligjore specifike që rregullojnë ushtrimin e aktivitetit të investimeve dhe gjithashtu aktet ligjore lidhur me mbrojtjen e mjedisit si më poshtë:

➤ **Përmbledhja e legjislationit**

- Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
- Ligji Nr.10 431, datë 09.06.2011, "Për Mbrojtjen e Mjedisit"
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit"
- Ligji Nr.10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003, "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta"
- Ligji Nr. 8094, datë 24.04.2003, "Për largimin publik të mbeturinave"
- Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"
- Ligji Nr. 9108, datë 17.7. 2003, "Për Substancat dhe Preparatet Kimike"
- Ligji Nr.8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me: Ligjin Nr.9826, datë 1.11.2007
- Ligji Nr. 12/2015, datë 26.02.2015 për disa ndryshime në ligjin Nr 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
- Ligji Nr.81, datë 4.05.2017 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligji Nr. 9868, date 4.02.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligji Nr.10006, datë 23.10.2008" Për mbrojtjen e faunës së egër", i ndryshuar
- Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar
- Ligji Nr 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji Nr.10266, datë 15.04.2010 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
- Ligji Nr.9425, datë 06.10.2005 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe"
- Ligji Nr.10 422, datë 26.05.2011 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në rreze të gjatë" për financimin afatgjatë të programit bashkëpunues për monitorimin e vlerësimin e transmetimit në rreze të gjatë të ndotësve të ajrit në Europë (EMEP)
- Ligji Nr.10 476, datë 3.11.2011 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, për të pakësuar acidifikimin, eutrofikimin dhe ozonin në shtresën e poshtme të atmosferës"
- Ligji Nr.10 062 , datë 29.01.2009 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare " të konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"

- Ligji Nr.9548 , datë 01.06.2006 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e regjistrave të shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve
- Ligji Nr.10 063 , datë 29.01.2009 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30%" " të konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"
- Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë"
- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve" i ndryshuar: VKM Nr. 579, datë 3.9.2014
- VKM Nr. 13, datë 13.01.2013, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis"
- VKM Nr. 419, datë 25.06.2014, "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi tipi A, B dhe C"
- VKM Nr. 676, datë 20.12.2002, "Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror"
- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse"
- VKM Nr.435 datë 12.09.2002, "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- VKM Nr. 247, datë 30.4.2014, "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"
- Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të Deklaratës Mjedisore"
- Udhëzim Nr. 3, datë 03.09.2009, "Për metodologjinë e vlerësimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis"
- Vendim Nr. 371, date 11.6.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"
- VKM-së Nr. 866, datë 4.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
- Vendim Nr. 352, datë 29.04.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të"
- Vendim Nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"
- Vendim Nr,781, datë 14.11.2012 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lengëshme për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim mjetet e transportit ujqor (detar,lumor dhe liqenor)
- Vendim Nr,248, datë 24.04.2003 "Për miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër dhe zbatimin e tyre"
- Vendim Nr,435, datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- Vendim Nr,803, datë 04.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit"
- Vendim Nr,781, datë 14.11.2012 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lengëshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorimin e mjeteve të transportit ujqor (detar,lumor dhe liqenor)"

- Vendim Nr.123, datë 17.02.2011 "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis"
- Vendim Nr.587, datë 07.07.2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike"
- VKM nr. 320, datë 21.04.2011 "Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese"
- Urdhri i Ministrise së Energjise dhe Industries, Nr 107, date 10.03.2014 "Për miratimin e Planit Vjetor Minerar 2014".

Ligji Nr. 10 440, datë 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

- a) Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) Garantim i një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Sipas kreut II, neni 7 "Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis" i këtij ligji citojmë:

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.
2. Proçedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:
 - a) Proçesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis
 - b) Proçesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis

Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për Mbrojtjen e Mjedisit"

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vëndit.

Në bazë të këtij ligji, neni 3 i tij, citojmë objektivat e mbrojtjes së mjedisit.

- a. parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d. përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f. mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit

➤ **Klasifikimi i projektit**

Bazuar në ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" (I ndryshuar), kreu II, neni 7, "Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.

Klasifikimi i raportit të VNM-së bazohet në shtojcat I dhe II të veprimtarive të përcaktuara në shtojcat e ligjit të VNM-së.

- Neni 8, projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë: projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur ligjit të VNM-së;
- Neni 9, procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: projektet e listuara në shtojcën I;
- Neni 11, Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për VNM-në paraprake: Në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së, AKM-ja merr vendim nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.

Projekti në studim është objekt i ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, shtojca I:

Pra, projekti në fjale i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar bazuar në Ligjin Nr. 10 440, datë 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar, **Neni 9**, procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: projektet e listuara në **shtojcën I**; pika 19: Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar. Sipërfaqja e projektit përfshin një sipërfaqe prej 7.7 Ha.

Klasifikimi i projektit ose veprimtarisë:

VNM e thelluar	X
VNM paraprake	
Nuk ka nevojë për VNM	

Mbështetur në këtë klasifikim ligjor raporti i thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të hartohet sipas kërkesave të Vendimit nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

2.3 Vendodhja Gjeografike e Projektit

Vendodhja e projektit ndodhet në Qarkun e Elbasanit, Bashkia Prrenjas, njesia administrative Qukes, fshati Skroske me Nr të zonës së minierës 516/7 Skroske. Ndodhet në një largësi rreth 4.2 km nga rruga automobilistike Librazhd-Prrenjas (nga ura e Bushtrices). Ndersa në vijë ajrore është një largësi 7 km nga qyteti i Prrenjasit edhe 16 km nga qyteti i Librazhdit. Objekti bën pjesë planshetin K-34-101-D-b të shkallës 1:25 000 dhe kufizohet nga koordinata sipas sistemit gjeografik Gauss Kruger:

Pika	Koordinatat Gauss Kruger	
	E=X	N=Y
1	45 54 097	44 57 001
2	45 54 261	44 56 881
3	45 54 440	44 57 207
4	45 54 256	44 57 325

Tablea 1- Koordinatat e projektit ne Gaus Kruger




Figura 1- Planvendosja e projektit ne harte topografike shk 1: 25 000

2.4 Vendodhja administrative

Projekti zhvillohet ne qarkun e Elbasanit, dhe me ndarjen e re territoriale shtrihet bashkine e Prrrenjasit, Njesia Administrative Qukes, Fshati Skroske.



Figura 2- Harta Territoriale e Qarkut Elbasan

Qarku Elbasan shtrihet ne zonen qendrore te Shqiperise. Ka nje siperfaqe te pergjithshme prej 3292 km² dhe nje popullsi prej 433.244 banore. Kufizohet ne veri dhe veriperendim me qarkun e Tiranës, ne lindje dhe juglindje me qarkun e Korces, ne perendim dhe jugperendim me qarkun e Beratit. Administrativisht, Qarku ka 7 bashki (Elbasan, Librazhd, Peqin, Belsh, Prrrenjas, Gramsh, Cerrik), 43 njesi administrative dhe 386 fshatra.

Përrenjasi kufizohet në veri me bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Përrenjasit.



Figura 3- Harta Administrative e Bashkise Prrrenjas

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Përrenjas, Qukës, Rrajcë dhe Stravaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 25 fshatra.

Sipas Censurit të vitit 2011, Përrenjasi ka një popullsi prej 24,906 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 33,031 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322.95 km². Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km² ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 102.279 banorë/km².

Klima e Qarkut Elbasan karakterizohet nga një klimë mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Reshjet bien kryesisht në stinën e dimrit dhe të vjeshtës me një mesatare prej 1490 mm në vit. Temperatura mesatare vjetore është 15.4°C. Për sa i përket relievit 38% e përbejnë malet, 28% e përbejnë fushat dhe 34% e përbejnë kodrat.

Qarku përshkohet nga dy lumenj: Shkumbini e Devolli. Arteri kryesor hidrografik i Qarkut është lumi Shkumbin që rrjedh nga juglindja drejt perëndimit duke e ndarë rrethin e Elbasanit në dy pjesë të barabarta. Ka një sipërfaqe të pellgut ujembledhës 1062 km² dhe gjatësi 90 km. Gjate rrugës merr shumë përrenj si: Rrapuni, Gostima, Shushica, Zaranika, Manazderia, etj.

Në pasuritë hidrografike të Qarkut të Elbasanit hyjnë edhe rezervuarët dhe liqenët. Rrethi i Elbasanit ka një sipërfaqe ujore rreth 650 ha të cilat përbehen nga liqene natyrore dhe rezervuarë të ndërtuar për qëllime vaditjeje. Përkatesisht rezervuarët zënë një sipërfaqe prej rreth 342 ha dhe janë rreth 33 të tilla, ndërsa liqene janë 34 të tilla dhe zënë një sipërfaqe prej 310 ha. Kur flasim për liqenët natyrore nënkuptojmë zonën e Dumresë. Numri prej 34 që përmendem më lart është me i madh gjatë dimrit, por ky pakesohet gjatë verës sepse shumë prej tyre janë të ceket dhe thahen.

2.5 Topografia dhe morfologjia

Nga pikepamja e relievit, vendburimi i kromit Skroske është i vendosur në një terren kodrinor të thyer. Kuota më e sipërme e terrenit është +700 dhe kuota më e poshtme +500. Terreni kodrinor ka favorizuar hapjen e vendburimit me punime horizontale nga sipërfaqja. Terreni është tipik malor. Relievi i zonës përfaqësohet nga një shpat me rnie të përgjithëshme drejt ve-riut me kënd të fortë rnie rreth 25-30°, por në disa raste ka pjerrësi më të madhe. Shpati është i aksi-dentuar nga kater përrenj me drejtim rrjedhje jug-veri.



Figura 4- Pamja e Lugines ku ndodhet miniera



Figura 5- Pamje nga zona e minieres



Foto 6- Pamje nga zona e minieres



Foto 7- pamje nga zona e minieres



Foto 8- Pamje nga Miniere

Gjithe rajonin e ketij sektori ne kemi te bejme me rajon maloro-kodrinor dhe lugina ne forme V, si dhe gropa te madhesive te ndryshme. Gati ne qender te zones kalon nje prroi i Bushtrices qe ka prurje relativisht te qendrueshme te ujit.

Zona eshte e pershkuar nga rruge te kategorise se katert dh ne lindje te saj kalon rruga e kategorise se trete qe shkon drejt fshatit Skroske dhe me tutje per te lidhur fshatrat e zones. Objektet lidhen me rruge automobilistike rurale te kategorise se peste si dhe me rrugen nationale Pogradec-Perrenjas-Librazhd –Elbasan e me tutje qe duhet thene se kjo eshte ne gjendje te mire.

2.6 Përshkrimi i karakteristikave klimatike

Territori i zones se sipercituar karakterizohet nga klime tipike kontinentale, me vere te fresket dhe dimer te ftohte dhe te acarte. Gjate veres temperaturat arrijne deri ne +20 deri +250 C, ndersa ne dimer ato zbresin deri ne -15 apo -200 C. Temperatura mesatare vjetore luhetet ne kufijte e +5 deri ne +100 C, por edhe me pak. Vera eshte e thate me pak rreshje shiu shpesh ne forme rrebeshi te shoqeruar me rrufe karakteristike kjo per zonat malore. Gjate dimrit bien rreshje te shumta debore lartesi e se ciles shkon ne 1-2m, por shpesh edhe me shume.

Bora fillon te bjere ne fillim te nentorit, por ka raste dhe me heret dhe vazhdon te bjere pothuajese pa nderprerje deri ne fund te muajit Mars, gjithashtu ky territor rrihet pothuajese gjate gjithë vitit nga erera me shkalle mesatare deri te forta, por me se shumti ne fillim te vjeshtes deri ne fundin e pranveres qe vijne nga Qafa e Murren. Keto kushte klimatike çojne shpesh ne nderprerje te punes nga ana e subjektit sidomos ne periudhen Nentor-Mars ne punimet siperfaqesore, periudhe e cila eshte marre parasysh nga subjekti gjate periudhes se shfrytezimit te rezervave te zbuluara ne kete shesh te lejes minerare.

Rrjeti hidrografik ne kete zone eshte mjaft i zhvilluar dhe perfaqesohet nga kater perrenj malore qe jane; Perroi i Kungulleshes ne lindje, Perroi i Peshkut dhe i Varices ne mes dhe ai i Shesheve ne

perendim. Ky eshte me uje pothuajese gjate gjithe vitit, pasi furnizohen nga liqenet malore akullnajore te Kacnise qe ndodhen ne nje lartesi mbi 1800 m dhe theksojme se ne kohe rreshjesh jane te rrembyeshem per shkak te pjerresise se madhe te shpatit duke u bere shpesh te pakalueshem, pasi sjellin masa te konsiderueshme prurjesh te ngurta. Gjate veres kane pak uje e ka raste qe dhe mund te thahen.

Nga ana hidrografike mund te themi se objektet kane kushte te favoreshme pasi daljet kromitike jane ne pjeset me te larta te relieve te kesaj zone. Gjithashtu mund te se dhe kushtet hidrogeologjike te zones jane te thjeshta, pasi niveli i ujerave nentokesore eshte relativisht thelle dhe rrjeti hidrografik luan rol pozitiv duke shryer si drenazh i ujerave dhe krijuar kushte per kryerjen e punimeve te kerkim-zbulimit.

2.7 Ndikimi në habitat dhe objektet me status të veçantë

Miniera e Skroskes e cila ka qene miniere egzistuese qe prej 1988, me periudha te ndryshme kohore deri 2019, ndodhet 1.1 km ne vije ajrore nga zona e mbrojtur parku kombetar Shebenik- Jabllanice (kategoria II), shpallur me ane te te VKM Nr.640, datë 21.05.2008.




Figura 9- Distanca me e afert e projektit me zonen e mbrojtur

Punimet qe do te kryhen ne miniere me nje afat kohor 3 vjecar nuk do te ndikojne drejtpersedrejti ne zonen e mbrojtur, parku kombetar pasi ndodhen ne nje distance te konsiderueshme edhe mjetet qe do te perdoren per nxjerrejen e Kromit do te jen penumatike, qe nuk krijojne nivel te larte zhurmash ne mjedis.



Figura 10- Vaska e Peshkut

Gjithashtu ne afersi te projektit ndodhet edhe nje vaske peshku, 300 m larg nga miniera, qe ndodhet ne pjesen e poshtme te projektit (Jug-perendeim). Gjate punimeve duhet te kete kujdes qe mos te ndotet uji ne lumin e Bushtrices. Kompania do marre te gjitha masat e nevojshme qe mos te kemi ndotje ne uje gjate kryerjes se punimeve.

Projekti nuk prek mjedisin ndërkufitar. Projekti ne fjale zhvillohet i gjithe ne territorin e republikes se Shqiperise.

3. Skicat dhe planimetrite kryesore te projektit

Formacionet shkëmbore nga të cilat ndërtohet vendburimi në fjalë dhe mbi të cilat do të zhvillohet veprimtaria minerare, klasifikohen ne grupin e I-rë (shkëmbinj te forte), me qëndrueshmëri të mire, gjatë hapjes dhe zhvillimit të punimeve minerare nëpër to. Nëpër zonat tektonike, ku është rritur shkalla e serpentinizimit të shkëmbinjve mëmë, ulet ndjeshëm qëndrueshmëria e tyre.

Sistemi per shfrytëzimin e minieres eshte ai me nenkate (rekomandohet). Lartesia e katit do te jete ne vartesi te dimensioneve ne renie te trupave minerare, pasi sipas shkalles se njohjes se trupave ne kete vendburim ka luhatje te medha dhe trashesi e trupave eshte e vogel. Lartesi e nenkatit do te jete 5-6-8 m, por gjithnje kjo do te gjykohet sipas situates konkrete. Lartesi kati per panelin +535, +570 do te jete 35 m ndersa ndersa nen nivelin +510 do te jete 25m.

Per pjesn nen kuoten +510m, ne varertesi te rezervave qe eventualisht mund te zbulohen do te percaktohet ne nje faze te mevonshme me projekt qe do te hartohet nga drejtuesit e minieres. Kjo eshte e kushtezuar edhe nga ekzistenca e trupave te mineralit te cilat ne kete vendburim jane mjaft te coptuar nga tektonike dhe te paqendrueshem ne trashesi. Per mbetjet e shfrytëzimit do te hartohet

pasaporte e veçante per shfrytezimi e secilit sipas kushteve specifike duke u realizuar gjithnje ne prezence te drejtuesit teknik.

- Gjatesia e bllokut 16-20-25m
- Lartesia e nenkatit 5-6-8m
- Largesia e hinkave te vjelejes se mineralit 4-6m.

Per rrezimin e mineralit do te perdoren bira me thellesi 2-2.5 m. Birat do te behen me çekiçe shpues te zakonshem me mbajtese pneumatike, ne tavan te galerise se nenkatit. Marrja e bllokut, sipas rrethanave do te behet nga kufiri per ne qender mbasi blloku parashikohet te pergatitet me oxhak ne qendert e tij . Gjatesia e nenkatit eshte e vogel 15-18 m dhe oxhaku qendror ne profilin 2-2 e ndan ate ne dy pjese relativisht te shkurtra .




Figura 11- Planvendosja e Minieres ne Harte Topografike




Figura 12- Harta Gjeologj Topografike e zones se projektit




Figura 13- Prerjet gjeologjike




Figura 14- Planimetria e punimeve minerare




Figura 15- Planimetria e mbylljes se minieres minieres

4. PERSHKRIMI I PROCESIVE NDERTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE

Punet ndertimore te lidhura ngushtë me realizimin e projektit parashikohen si me poshte:

- Ngritje kantieri dhe vendosja e e zyres
- Rikonstruksioni i rrugeve te aksesit
- Lidhja me rrjetin elektrik te zones
- Ndertimi i nje mur mbajtes i sheshit prane hyrjes se galerise +550
- Ndertimi I nje kanali per kullimin e ujrave
- Punime per hapjen e puseve dhe nxjerrës se mineralit
- Ndertimin e te gjitha veprave me permasa te caktuara ne projekt
- Transporti i mineralit te kromit per ne hyrjen e galerise
- Transporti i Mineralit te kromit per ne piken e grumbullimit
- Mbyllja e e hyrjeve te galerise per siguri teknike pas mbarimit te punimeve



Figura 16- Ure lidhese ne kuoten +530

- *Proceset kryesore te projektit:* Shfrytezimi i mineralit te kromit per tregtim vendas edhe eksport
- *Kapaciteti :* 2 500 ton/vit mineral kromi.

4.1 Hapja dhe shfrytezimi i vendburimit te minieres

Shfrytezimi do të bëhet me punime nentokesore, në përputhje me kërkesat e ligjit Nr 10304, date 15/07/2010 "Per Sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", si dhe të të gjitha akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Vendburimi i kromit Skroske per vete pozicionin e vendosjes, ne terren kodrinor eshte hapur kryesisht me punime horizontale. Duke filluar nga lart-poshte niveli +661 eshte niveli me i siperm i pergatitjes dhe shfrytezimit. Nivelet e tjera poshte tij u hapen cdo 20-30 metra lartesi.

Punimet kryesore te katit u hapen me seksion 5.2 m2. Kane ecur ne pergjithesi ne formacione me qendrueshmeri te mire. Gjate hapjes nuk eshte perdorur armatim, me perjashtim te hyrjeve dhe kryqezimeve e zonave tektonike.

Ne shfrytezimin e trupit te kromit eshte perdorur sistemi i shfrytezimit me galeri nenkati e me hapësira te hapura pas shfrytezimit. Per trashesine e vogel te trupit (mesatarja 0.8 m), lartesia e nenekateve eshte marre jo me e madhe se 6 metra.

Mbeshtetur ne analizen qe i eshte bere treguesve te humbjes e varferimit nga specialistet ne projekt programet vjetore qe nga viti 1988 e deri ne vitin 1992 rezultojne keta treguesat:

- Humbjet e mineralit 14-16.5% mesatarisht 15%
- Varferimi i mineralit 17.9-20%, mesatarisht 18%

Pjesa e varferuar e mineralit do te seleksionohet me dore per te mudesuar prodhimin e mineralit me permbajtje gati sa ajo ne bllok.

Per trupa te tille ne shfrytezim ne kete miniere eshte perdorur sistemi i shfrytezimit me galeri nenkati. Ky sistem rekomandohet edhe ne te ardhmen ku lartesia e katit do te jete ne vartesi te dimensioneve ne renie te trupave minerare, pasi sipas shkalles se njohjes se trupave ne kete vendburim ka luhate te medha dhe trashesi e trupave eshte e vogel. Lartesi e nenkatit do te jete 5-6-8 m, por gjithnje kjo do te gjykohe sipas situates konkrete.

Lartesi kati per panelin +535-+570 do te jete 35m ndersa ndersa nen nivelin +510 do te jete 25m. Per pjesn nen kuoten +510m, ne vartesi te rezervave qe eventualisht mund te zbulohen do te percaktohet ne nje faze te mevonshme me projekt qe do te hartohet nga drejtuesit e minieres. Kjo eshte e kushtezuar edhe nga ekzistenca e trupave te mineralit te cilat ne kete vendburim jane mjaft te coptuar nga tektonike dhe te paqendrueshem ne trashesi. Per mbetjet e shfrytezimit do te hartohet pasaporte e veçante per shfrytezimi e secilit sipas kushteve specifike duke u realizuar gjithnje ne prezence te drejtuesit teknik.

- Gjatesia e bllokut 16-20-25m
- Lartesia e nenkatit 5-6-8m
- Largesia e hinkave te vjelejes se mineralit 4-6m.

Per rrezimin e mineralit do te perdoren bira me thellesi 2-2.5m. Birat do te behen me çekiçe shpues te zakonshem me mbajtese pneumatike, ne tavan te galerise se nenkatit. Marrja e bllokut, sipas rrethanave do te behet nga kufiri per ne qender mbasi blloku parashikhet te pergatitet me oxhak ne qendert te tij. Gjatesia e nenkatit eshte e vogel 15-18 m dhe oxhaku qendror ne profilin 2-2 e ndan ate ne dy pjese relativisht te shkurtra.

Radha e drejtimi i shfrytezimit

Me marrjen e lejes se shfrytezimit ne objekt do te behet ringritja e punimeve panelin +570 si dhe do te riparohet pjeserisht fyrja e galerise +580 qe do te sherbeje si punim ajrimi dhe rrugedalje duke ringritur punimet horizontale dhe oxhaqet lidhes qe sherbejne per transport, ajrim e rrugedalje te dyta. Njekohesisht do te behet azhornimi i punimeve hap pas hapi per te konkluduar ku do te fillohet shfrytezimi ne cilin bllok, pjese te bllokut apo celik.

Per hapjen pergatitjen dhe shfrytezimin e panelit +535-+570 parashikohen te kryhen punimete si ne tabelen e meposhteme:

Tabela Nr. 1- Punimet Minerale te nevojshme

Nr	Emertimi	Njesai	Horizontale	Pjerrta +vertikal
1	Horizonti 550m	ml	28	
2	Dhoma e arganellos +550	ml	4	
3	Dishenderi 550-535	ml		40
4	Horizonti 535m	ml	100	35
5	Horizonti 510m	ml	35	90
Shuma ml			167	165

Paraprakisht ne panelin 535 -570 jane parashikuar te kryhen rreth kete panel do te kryhen rreth 180 ml punime minerare, traversa e oxhaqe qe do te sherbejne per pergatitjen e shfrytezimin e rezervave te mineralit ne kete panel.

Shfrytezimi do te filloje nga lart poshte duke perdorur si horizont transporti galerine +535 Gjatesia e vogel ne shtrirje (Shiko projektionin vertikal) ben qe te jete vetem nje bllok ne shfrytezim i cili do te shfrytezohet nga kufiri.

Tabela Nr 2- Grafiku i kryerjes se Punimeve

Nr	Emertimi i punimit	Njesia	Sasia totale		V i t e t					
					I		II		III	
			Horizontale	Pjerrta +vertikal	horizontale	Pjerrta +vertikale	horizontale	Pjerrta +vertikal	horizontale	Pjerrta +vertikal
1	Horizonti 550m	ml	28		28					
2	Dhoma e arganellos +550	ml	4		4					
3	Dishenderi 550-535	ml		40		40				
4	Horizonti 535m	ml	100	35	40		40	35	20	
5	Dishenderi 535-510			65				30		35
6	Horizonti 510m	ml	35	25					35	25
Shuma ml			167	165	72	40	40	65	55	60

4.2 Lendet e para qe do te perdoren

- Karburanti (per venien ne pune te makinerive te transportit dhe atyre teknologjike gjate kohes se ngritjes se kantierit edhe operimit)
- Energjia elektrike (per venien ne pune te makinerive gjate periudhes se ngritjes se kantierit, ndricim edhe gjat procesit te punes per nxjerrjen e mineralit)
- Uji (uje per perpunimin e materialeve gjate kohes se ndertimit qe sigurohet nga me ane te pomave ose autobotave)
- Lende ndihmese jane betonet per sistemimin e kanalit te rrjedhjes se se ujit, mure mbrojtese per siguri teknike edhe per mbylljen e galerise. Ajer i kompreuar qe do te perdoret per cekicin per shim me ane te nje kopresori me 10 m³/ min.
- Produkti perfundimtar eshte nxjerrja e kromit

4.3 Aktivitete te tjera qe kerkon projekti

Ajer i kompresuar qe do te perdoret per furnizimin e cekicit pneumatik per shpim. Nje sasi prej 10 m³/ min eshte i mjaftueshem, cka do te sigurohet me ane te nje kompresori.

4.4 Produkti

Prodhim i mineralit te kromit me nje sasi prej 2 500 ton/vit e cila pas seleksionimit do te dergohet ne portin e Durrësit si per tregun vendas por edhe per eksport. Shfrytezimi i kesaj miniere do te jete prej 3 vitesh.

5. TE DHENA PER INFRASTRUKTUREN, FURNIZIMIN ME UJE ,SHKARKIMET E UJRAVE DHE MBETJEVE, RRUGET EKZISTUESE DHE HAPJA E RRUGEVE TE REJA.

5.1 Furnizimi me uje

Furnizimi me uje do te behet ne rrjetin e zones edhe me ane te nje pompe e cila do te dergoje ujin en nje depozite e cila do te vendoset ne piken me te larte te minieres ku me pas do te rrjedhe me gravitet (rrjedhe te lire). Ne kete meyre behet e mundur edhe kursimi i energjise.

5.2 Furnizim me energji elektrike

Lidhja me rrjetin elektrik do te behet me ane te rrjetit elektrik te zones. Prane minieres ndodhet nje gabine elektrike qe furnizon fshatin, ku do te behet edhe lidhja elektrike qe do te perodret per nevojate puneese ne miniere qe jane perdorimi i kompresorit, per zyrat, ndricim, pomppimin e ujit edhe ventilim te ajrit. Linja elektrike qe synohet te ndertohet ehte 320 m nga gabina deri te miniera.



Figura 17- Pamje e gabines elektrike

5.3 Rruget ekzistuese dhe rruget e reja

Do te behet rikonstruksioni i rruges egzistuese qe fillon nga rruga automobilistike Librazhd-Prrenjas (ura e Bushtrices) deri ne miniere me nje gjatesi afersisht 4.2 km. Gjithashtu do te hapet edhe nje rruge 90 ml per akese me te qendrueshem ne miniere. Vlera e ketyre investimeve eshte parashikuar 470 000 leke.

5.4 Shkarkimet e aluvjoneve

Shkarkime te ujrave te ndotura nuk ka nga ky prces pune. Gjate punimeve ne miniere, ne raste te vecanta nese do te kete shkarkim te ujrave qe dalin nga proceset e pune, keto ujrave do te pompohen edhe to te dergohen ne vendet e trajtimit te ujrave, ose perpara se te derdhen ne lum do te behet nje paratrajtim i tyre. Ndersa per nevojat personale do te vendosen tualete portative edhe me grope septike.

6. PROGRAMIN PËR NDËRTIMIN, KOHËZGJATJEN E NDËRTIMIT, KOHËZGJATJEN E PLANIFIKUAR PËR FUNKSIONIMIN E PROJEKTIT, KOHËN E MUNDSHME TË PËRFUNDIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT DHE, SIPAS RASTIT, EDHE FAZËN E PLANIFIKUAR TË REHABILITIMIT TË SIPËRFAQES, PAS MBARIMIT TË FUNKSIONIMIT TË PROJEKTIT

6.1 Kohezgjatja e ndertimit dhe operimit

Vazhdimi I punimeve te projektit do filloje menjehere pas sigurimit te lejeve ne baze te legjislacionit ne fuqi, ku nje nder to eshte dhe leja mjedisore. Sipas vendimit te Ministrise se Infrastruktura edhe Energjise, shfrytezimi i kesaj miniere do te jete me nje afat kohor prej 3 vitesh nga data e fillimit te

punimeve. Pas shfrytezimit te mineralit te kromit do te behet edhe mbyllja e minieres sipas planit te menaxhimit te mjedist.

6.2 Pershkrimi flores edhe fanues

- **Flora**

Pellgu i perroit e Bushtrices ku ndodhet edhe Miniera Skroske karakterizohet në përgjithësi nga një relief tipik Kodrinoro-Malor— në pjesën e sipërme dhe të mesme. Pak a shumë forma masive malore e këtij pellgu është e thepisur ne forme V, ku shpatet ngrihen butë në pjesën fundore dhe pjerrësia vjen më e vogël. Kuotat ku ndodhet Miniera jane midis 500 m mnd dhe 700 m mnd.

Kryesisht mbizoterohet nga brezi i shkurreve ku pershihet shkoza dhe mbretja, dellinja. Ne kodrinat perrrth gjendet dushku. Ndersa pergjate shtratit te perroit pothuajse nuk ka vegjetacion pasi shpati eshte shum i thepisur dhe me shkembinj, cka ben qe mo te kemi vegjetacion ne kete pjese te perroit. Ndersa ne anen e djathte vetegjacioni eshte me i dukshem, ku pjeserisht eshte dollonje edhe dushk jo i dendur. Ne kodrat ne pikat me te larta gjendet kodra te mbuluara me pishe.



Foto 18- Foto nga zona e minieres



Figura 19- Foto nga vendodhja e projektit ne lumin e Bushtrices

Ndersa ne fillim te rruges ruese (ura e Bushtrices) 4.2 km larg nga miniera kemi shfaqen e shelgut, plepit edhe rrapit. Gjithashtu edhe bimesia eshte me e dendur pasi eshte zone me pjerrsi me te vogel edhe lugine me e gjera, ku vegetacioni eshte i pranishem.



Figura 20- Ura e Bushtrices (Bashkimi i lumit te Bushtrices me ate Shkumbin)

Bimësia që preket nuk kanë ndonjë funksion të vecantë, zona që do të preket do të rehabilitohet sipas kushteve të projektit, ku do të behet me e detajuar në planin e rehabilitimit të mjedisit. Duhet të theksojmë që të gjitha punimet do të kryhen në gjurmen egzistuese të projektit, ku kjo miniere ka qenë e shfrytëzuar me pare, dhe demet në mjedis do të jenë të minimizuara. Gjithashtu do të mbahen kontakte me drejtorinë rajonale të administrimit të pyjeve Elbasan.

- **Fauna**

Zona, për shkak të kushteve të veçanta të regjimit atmosferik, klimatik e gjeologjik, është e pasur në bimësi dhe në faunë. Fauna dhe flora formojnë një sistem ekologjik tepër kreativ dhe me vlera mjedisore. Fauna është karakteristike e faunës që jeton në zonën e pyjeve të dushkut, dhe bimëve të tjera gjethegjenese. Zona ka edhe faunë të egër të larmishme, por si kudo në vendin tonë ajo është dëmtuar shumë nga gjuetia pa kriter depërtimi i njeriut, nga përdorimi i kimikateve, zjarret etj. Ndër llojet e botës shtazore përmendim kafshët tipike si derri i egër (sus Skrofa), që tani gjendet shumë rrallë. Në zonë mund të gjenden edhe ujku (Canis Lupus), lepuri (Lepus Europeus), kunadhja (Martes Foina), dhelpra (Vulpus-Vulpus), bagetia e imët etj. Kafshet shtepiake si Lopa, delja, dhia ku një pjesë e njerzve të zones janë punësuar dhe i përdorin për nevojat e tyre si edhe për të tregtuar qumështin dhe neproduktet e tij.

Zona është e pasur me shpendë të tilla si thëllëza e malit (Perdix-Perdix), bufi, dallandyshja, harabeli, pëllumbi, e shumë e shumë shpendë dhe kafshë të egra etj. Ligji për mbrojtjen e mjedisit, vecanësisht ligji Nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë”, ndalon gjuetinë për 5 vite, ka shtuar faunën e egër në këto zone, duke shtuar një vlerë të vecantë.

Ndër llojet e peshqëve që rriten në këto pellg ujembledhes janë Mlyshi- I takon familjes së krapit (ciprinide). Mund të rritet ndonëse ralle edhe deri në 4-5 kilogram, mirepo llojet prej 2 kilogramesh gjenden më shpesh të varura për grepin e peshkatarit dhe konsiderohen si një gjah që vlen të peshkohet. Është shumë përhapur në ujërat fushore mirepo gjendet edhe në ujërat e lartësive. Edhe mlyshi, përderisa është më i ri, jeton në grupe, të cilat udhëhiqen nga peshqit më të mëdhenj. Trofa është peshk i ujërave të ëmbla që jeton në shumicën e lumenjve Shqipërisë. Troftat gjenden kryesisht në ujëra të ftohta e të kthjellëta, të temperaturave prej 10–16 °C. Sardelja është peshk karakteristik i këtij pelgu gjithashtu. Ai shumohet në maste të madhe dhe ka një gjatësi 10-15 cm. Gjatë vërtetimeve në terren nuk është vërejtur peshq perroi e Bushtrices për vetë faktin se përjetësia e perroit është e madhe dhe nuk bën të mundur një ekosistem të pershtatshëm për rritjen e peshqëve.

6.3 Pershkrim i ndikimeve në mjedis

Cdo aktivitet njëzëz mbi mjedisin natyror shkakton ndikime të ndryshme mbi të, i cili mund të jetë i vogël ose i madh, mund të jenë pozitiv apo negativ, i drejt për drejt apo i terthorë. Për të vlerësuar karakterin e ndikimit, të përmasave dhe faktorët e mjedisit mbi të cilët ushtrohen ndikimet është e nevojshme hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimeve Mjedisore (VNM). Objektivi kryesor i VNM është që vlerësimi i cdo aktiviteti njëzëz mbi mjedis të arrihet pas një studimi të thelluar i cili ka patur si qëllim kryesor menaxhimin sa më të mirë të burimeve natyrore. Ndikimet që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të burimeve natyrore të shmangen nëse është e mundur dhe nëse jo, niveli i ndikimit mbi mjedis të jetë i ulët.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor përmban në themelin e tij vlerësimin e ndikimeve mbi mjedis dhe në jetën sociale.

- Ndikim eshte termi i cili nenkupton cdo ndryshim, negativ ose pozitiv i cili ushtrohet mbi karakteristikat e mjedisit (Jacob et al. 2008).
- Vlersimi i ndikimit perkufizohet si procesi i analizes te parashikimit dhe vleresimit te ndikimit, i cili mund te lind nga cdo lloj aktiviteti njerzor para se ai te ushtrohet mbi mjedis (Jacob et al. 2008).

Ne referencat e ndryshme shpesh here pershkruhen perkufizime te ndryshme se cfare eshte nje Raport Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (EIA: Environmental Impact Assessment), por te gjitha kane si objektiv mbrojtjen e mjedisit.

Vlersimi dhe masat zbutese te ndikimeve qe lindin gjate fazes ndertimore dhe operale te nje projekti mbi mjedis, jane pikat me te rendesishme ne VNM, sepse ne ne kete menyre shmangen rreziket dhe ndotjet qe mund te ndodhin ne mjedis. Gjithashtu VNM duhet te promovojte shfrytezimin e burimeve natyrore ne menyre te qendrushme (sustainable use).

VNM jep mundesine e hartimit te nje katalogu para zbatimit te projektit me ndikimet e mundeshme qe mund te shkaktohen nga projekti. Propozon masa parandaluese ne raste kur evidentohen ndikimet. Per kete arsye, nje VNM hartohet para cdo projekti dhe shqyrtimi i mire i saj con ne marrjen e vendimeve te sakta dhe gjithashtu sherben per zgjedhjen e alternativave me te mira dhe me miqesore me mjedisin.

Hartimi i nje VNM nuk eshte nje proces i thjeshte edhe i lehte, sepse cdo lloj projekti eshte i vecante dhe mjedisi ku do te operohet per te marre jete projektet e ndryshme eshte i ndryshem dhe cdo lidhje projekt-mjedis con ne nje rast unik te lidhjes shkak-perfundim. Nese ne vend te VNM do te shqyrtohej dhe do te analizohej kosto-perfitim nuk do te merreshin parasysh ndikimet e mundeshme ne mjedis. Prandaj objektivi kryesor i VNM eshte analizimi i hollesishem i te gjithave llojeve te ndikimeve ne mjedis dhe propozimi i zgjedhjes se alternatives me te mire qe ofron projekti.

Hartimi i ketij studimi Vleresimor Mjedisor dhe Social eshte bere ne perputhje me ligjin nr. 10 440, datë 7.7. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis". Nje metode vleresimi duhet te percaktoje te gjitha ndikimet te cilat lindin drejt per drejte apo ne menyre te terthorte nga ndertimi apo nga operimi i projektit dhe gjithashtu duhet te percaktoje ne cilen faze te projektit lindin dhe cila eshte kohezgjatja e tyre. Percaktimi i ndikimeve u realizua nga nje hulumtim i mire i projektit teknik dhe parashikimi i ndikimeve te mundeshme qe lindin gjate fazave te ndryshme te tij ne mjedis.

Per vleresimin e ndikimeve mjedisore te cilat parashikohne gjate zbatimit dhe operimit te projektit eshte pare e arsyeshme qe karakteristikat mjedisore te klasifikohen ne tre kategori:

- a) Indikatorët abiotike
- b) Indikatorët biotike
- g) Indikatorët social/ekonomik

Grupimi i faktoreve mjedisore ndihmon ne nxjerrjen e shpejte te nje konkluzioni per gjendjen e mundeshme te mjedisit, ndihmon ne ekzaminimin e problematikes duke mos humbur kohe dhe mbi te gjitha jep mundesine e krahasimit me ndikimet e te njejtës natyre ne VNM. Ne tabelen e meposhtme paraqitet klasifikimi i faktoreve mjedisore te cilet mund te ndryshojne ne lidhje me fazat e projektit. Ne vazhdimesi te VNM vleresohen te gjitha parametrat e poshtepemendura




Figura 15- Indikatorët mjedisor

Megjithese cdo aktivitet i cfar do natyre qofte karakterizohet nga disa efekte mjedisore negative apo pozitive te cilat sipas natyres mund te jene afatshkurtra ose/dhe afatgjata, te minimizueshme ose te eliminueshme. Evidentimi i tyre dhe marrja ne konsiderate gjate aktivitetit te ndikimit ne mjedis eshte parakusht per nje parneritet ne mbrojtjen e mjedisit.

Duhet te theksojme se shumica dermuese e punimeve pergatitore qe perfshin ky projekt jane kryer shume vite me pare e per pasoje ndryshimet nga kjo faze tashme jane pershtatur me mjedisin dhe jane bere pjese e tije si nje habitat i vetem.

- Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në tokë

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Shqetësim i shtresës së tokës për shkak të hapjes së karrieres, punimittë hapjes dhe gjysmë transheve	Krijim i hinkave ne sipërfaqe dhe ulje e sipërfaqes se tokes. Kjo sasi dheu mund të sistemohet përgjatë hapjes minieres dhe të përdorët në fazën e fundit për qëllime rehabilitimi
Shqetësim i nentokes per shkak te terheqjes se mineralit te kromit gjate shfrytezimit.	Krijim te hapsirave nentoksore. Ne sistemin e shfrytezimit parashikohet qe nje pjese e tyre dhe te rimbushet me sterile.
Lëvizje e mjeteve të punës dhe automjeteve të transportit si kamione fadroma etj, mbi sipërfaqen e tokës krijojnë ngjeshje te saja.	Ngjeshja e tokës nga lëvizja e automjeteve dhe mjeteve gjatë punimeve të rikonstruksionit dhe atyre të reja do të limitohet brenda sipërfaqes së kërkuar
Erozion minimal ne kohe me rreshje ne sipërfaqen ku do të hapet kariera	Largim i grimcave të tokes që ekspozohen ndaj agjenteve atmosferike duke u shkeputur dhe levizur kryesisht drejt trupave ujore si perrenjte dhe prroskat ne afersi te objektit
Avari teknike, derdhje e karburanteve dhe lubrifikantëve.	Ndotje e tokes si pasoje e rrjedhjes se lubrifikanteve dhe karburanteve po per shkak te vellimit jo te madh te punimeve dhe numrit te reduktuar te makinerive, ndotja do te jete ne sasi te vogla
Gërmime për shkak të hapjes së gjysmë transheve nga makinerite	Vibrim i tokës, por gjykuar nga volumi i punimeve do te jete nje vibracion normal teknologjik vetem ne nje zone te ngushte te objektit
Nga punët me lëndë plasëse në sipërfaqe dhe nëntokë	Shkriftim i shkëmbit mëmë dhe mineralit si dhe vibrim i zonës rreth ku bëhen punët e shpim plasjes.

- Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në ajër

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet	Ndotje e ajrit. Sasia e gazeve NO2 dhe SO2 qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara
Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes	Ndotje akustike nga mjetet e punës për bërjen e birave dhe për ngarkim transport të mineralit. Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te

	krijone probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe dhe nje pjese e tyre do te kryhen nentoke
Krijimin e sasive të pluhurit si pasoje e qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit	Ndotje ajri. Ky fenomen do te jete me l dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesojë kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle
Sasira minimale pluhuri nga cekicet pneumatike per birat e shpim –plasjes.	Lagje e vazhdushme e frontit te punes dhe vendosja e shpimit te lagur.

- **Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në uje**

Teknologjia shfrytezimit te objektit parashikon perdorimin e ujit per shpimin e lagur dhe sperkatjen e stoqeve. Ujrat e reshjeve do te dekantohen ne gropa brenda zones se shfrytezimit. Rrjedhja e me tejshme e tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre me ane te nje kanali ne ane te rruges se hapjes deri ne kanalin e rruges se poshtme. Meqenese terreni eshte i thepisur nuk kemi grumbullim te ujrave nentokesore, cka aktiviteti yne nuk do te ndikojë ne ndotjen e tyre. Nese gjate punimeve do te ndodhi ndonje aksident edhe kemi ndikim te ujrave ato do te pompohen edhe do te depozitohen ne rezervuare te vecanta ku me pas do te dekantojne per tu pastruar.

- **Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në biodiversitet**

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Ndërhyrje në habitatet ne zone , shqetesim i faunes.	Siperfaqja ku janë kryher punimet eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht, proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit, do te ushtrojne ndikimet e tyre ne boten e gjalle sidomos do te mbajne larg zones disa lloje shtazore.

- **Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në peisazh dhe relief**

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Ndikime ne pejsazh dhe topografine e terrenit ku ndodhet objekti si rrezultat i karierës dhe depozitimit të sterilit të punime minerare	Nder ndikimet me evidente do te jene ndryshime i reliefit dhe peisazhit, nga pjerrësia natyrale qe do te kene shkallët e karierës me lartësi 10 ml.. Stoqet e depozitimit të sterilit të punimeve minerare jane ekzistuese ato do të ndryshojnë gjithashtu relievin dhe peisazhin e vendik ku jan depozituar.

- **Mbetjet e ngurta**

Ndikimi i Mundshem	Pasojat ne Mjedis
Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor	Ndotje urbane. Kartona, bidona vaji, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjesve
Minerali dhe sterili ne sasira te konsiderushme	Zenie e siperfaqes se tokes per stoqet e depozitimit te sterileve qe dalin nga kryerja e punimeve dhe sheshet e depozitimit te mineralit te prodhuar.

- **Ndikimet negative shtesë.**

Veprimtaria minerare nxjerrës e mineralit të kromit, është veprimtari e cila nuk shoqërohet me ndikime negative shtesë, në cilësinë e mjedisit rrethues të minierës e më gjërë. Ky aktivitet nuk ndikon negativisht gjere në sipërfaqen apo bimësinë e ulët deri në pemët e larta, pyjet. Ky aktivitet nuk ka shkarkime të ujrave të ndotur, gjithashtu nuk ka shkarkime në trupat ujorë rreth minierës, lumenj, përrenj, rezervuarë, ujë mbledhës përfshi dhe burimet ujore.

Ndikimet sociale të projektit, të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet në mjedis të projektit (si zhurma, pluhuri, përdorimi i burimeve natyrore etj).

Ky projekt, nxjerrja e mineralit të kromit në minieren e Skroskes , shoqërohet me ndryshime të përdorimit të tokës aty ku është ndërtuar zona e miniera. Këto ndryshime nuk shoqërohen me ndikime negative të cilat të kenë ndikim negativ në jetën sociale. Ndikimet negative janë vetëm në reliev dhe në peisazh. Po ti analizojmë këto ndikime, ato nuk rezultojnë negative sepse janë ndryshime të pa shoqëruara me ndryshime të strukturës kryesore të tokës si dhe nuk shoqërohen me ndotje mjedisi apo me shkarkime të elementëve të dëmshëm për mjedisin.

Sterilet janë pjesë përbërëse e shkëmbinjve që formojnë zonën dhe relievin. Ndërkohë po të rendisim ndikimet pozitive të këtij aktiviteti (shfrytëzim të burimeve minerare për interes të njerëzimit, rritje e mrëqënijes së punonjësve, reduktim i papunësisë në zonë, kualifikim i mëtejshëm i puntorve, si dhe vend ndodhjen e minierës në një zonë shumë larg qendrave të banuara, sipërfaqen e vogël të shesheve, etj) dhe ti balancojmë me ndikimet negative vërejmë se ndikimet negative nuk përbëjnë problem. Gjithashtu është edhe permirsimi i infrastruktures se zones.

6.4 Masat zbutese per ndikimet ne mjedis

Në hapjen dhe shfrytëzimin e karrierës dhe minierës, është marë në konsideratë mbrojtja e mjedisit dhe standartet mjedisore si dhe të aplikohen masa konkrete.

- **Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne toke.**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Shqëtesim i shtreses se tokes per shkak te hapjes se minieres dhe hapjes së shesheve.	Sasia e dheut sistemohet pergjate shpatit dhe do te perdoret per qellime rehabilitimi ne faza te ndryshme te shfrytezimit ose per rehabilitimin e rrugeve dhe siperfaqeve te demtuara ne perfundim te shfrytezimit te minieres
Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit si kamione etj.	Per parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes do te shfrytezohen vendet e caktuara
Erozion siperfaqesor ne mot me rreshje	Janë hapur kanalet e drenazhimit ne sipërfaqe, qe do te ndalim forcën geryese te ujrave te reshjeve, ndersa pergjate perimetrit te sheshit te depozitimit te mineralit dhe hyrjes ne nentoke, janë hapur kanale perimetrike kufizuese qe frenojne gerryerjen dhe transportin e tokes sipas gradientit te pjerrtise nga ujrat siperfaqesore. Ne pjese te vecanta do te shihet mundesia e mbjelljeve te fidaneve pyjore te pershtatshem per zonen.
Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes	Makinerite e shfrytezimit dhe transportit kontrollohen per gjendjen e tyre teknike dhe nese konstatohen pjese te amortizuara qe mund te rrjedhin lubrikante zevendesohen me te reja. Ne rast te ndonje aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale te lendeve ndotese ne mjedis merren masa per pastrimin e menjehershëm te tokes se ndotur e cila do te depozitohet ne nje kazan te posatshem metalik ose prej betoni per t'u trajtur me pas

- **Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne ajer**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Emetime te pluhurit, zhurmes, gazeve, aromave dhe vibracione	Manikerite mirembahen teknikisht qe zhurma e tyre te jete vetem ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato perdoren me eficence dhe te minimizohet koha gjate se ciles mbahen ndezur motoret. Skapamentot jane të kompletuara me filtrat e tyre teknologjike te kapjes se grimcave (skapamentot e makinerive kane nje jastek te posatshem per kete gje). Perdoret nafte me permbajtje te ulet squfuri. Menjanohet renia e borive te automjeteve nga shoferet per te mos krijuar zhurme dhe stres të panevojshëm. Qarkullimi i kamioneve ne qendrat e banuara behet me shpejtesi te ulet gje qe shmang jo vetem aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.
Ndotja e ajrit si pasoje e qarkullimit te automjeteve brenda teritorit te minieres	Mjetet e transportit jane objekt i kolaudimeve periodike, gjithashtu ato jane objekt i kontrollit nga vete subjekti. Ne rastet kur ato emetojne gazra mbi normat e lejuara si rezultat i defekteve hiqen nga qarkullimi dhe riparohen.
Ndotja e ajrit si pasoje e punes me shpim -plasje	Ne keto raste behet lagia me uje perpara shpimit ne menyre qe te minimizohet sasia e pluhurit te gjeneruar. Perdoret kur eshte e mundur shpimi i lagur dhe punonjesit jane te paisur me maska. Ndersa ne zonat e banuara nuk do te kemi ndikime pasi miniera eshte larg tyre dhe shpimet behen ne miniere.

- **Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne uje**

Teknologjia shfrytezimit te objektit parashikon perdorimin e ujit per shpimin e lagur dhe sperkatjen e stoqeve. Ujrat e reshjeve do te dekantohen ne gropa brenda zones se shfrytezimit. Meqenese terreni eshte i thepisur nuk kemi grumbullim te ujrave nentokesore, cka aktiviteti yne nuk do te ndikoje ne ndotjen e tyre. Nese gjate punimeve do te ndodhi ndonje aksident edhe kemi ndikim te ujrave ato do te pompohen edhe do te depozitohen ne rezervuare te vecanta ku me pas do te dekantojne per tu pastruar. Gjithashtu do te behet mirembajtja periodike e kanaleve te kullimit qe mos te kemi ndikim ne ujra edhe errozion.

- **Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne biodiversitet**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Shqetesim i faunes se zone	Shfrytezimi i mineralit eshte domosdoshmeri por respektohet rigorozisht siperfaqja e lejes per nderhyrje .Punimet zhvillohen ne siperfaqe me kariere dhe nentoke me galeri te thelluara. Depozitimi i sterilite dhe mineralit te nxjerre depozitohen jashte ne siperfaqe. Prandaj behet shume kujdes dhe respektohen stoqet dhe sheshet e sterileve dhe te mineralit te trasheguara, ndersa mjetet dhe makinerite kontrollohen periodikisht.

- **Identifikimi i masave zbutese ne peisazh.**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Ndikime ne pejsazh dhe topografine e relievit, ne kariere dhe hyrje te galerive	Depozitimi i sterileve dhe mineralit ne siperfaqe demtojne siperfaqen e relievit. Keto siperfaqe do te rehabilitohen menjehere sapo te mbarojë shfrytezimi i karrierës.

- **Identifikimi i masave zbutese mbetjet e ngurta**

Lloji i Ndikimit	Masat e Propozuara
Depozitim i sasirave te konsiderushme te sterileve	Keto depozitime demtojne siperfaqen dhe relievin. Subjekti do te minimizojë sa me teper nxjerrjen jashte ne siperfaqe te sterileve pasi nje pjese te tyre(40%) do ti depozitohen ne hapsirat e nentokes te krijuar nga terheqja e mineralit.Keto siperfaqe jane objekt i rehabilitimit sapo te mbarojë shfrytezimi.
Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor	Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet grumbullohen në vende të posaçme. Ato transportohen drejt drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal.

6.4 Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

6.4.1 Sasise se gjenerimit te mbetjeve

Bazuar ne ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” si dhe VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, ku volume I mbetjeve te ngurta do te trajtohet sipas legjislacionit ne fuqi. Nuk parashikohet nje volum I madh te mbetje te ngurta, ku kryesisht jane sterilet qe perbejne terrenin ne vetvete, ku referuar territorit te zones, jane Shkembinj me permbajtje Kromi, te cilat do te sistemohen ne vendet ku do te eperaktohen se bashku me pushtetin Lokal te zones por edhe me Agjencie Rajonale te Mjedisit Elbasan.

Referuar VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, mbetjet e gjeneruara i klasifikohen sipas pikve:

Pika 13 Mbetje vajrash dhe mbetje te karburanteve te Lëngshme

1301- Mbetje te vajrave hidraulike

1302- Mbetje vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikante

Pika 16 Mbetje te pa specifikuara

16 01 03- Goma jashtë përdorimi

Pika 17. Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara)

1701- Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika

1702- Dru, qelqe dhe plastika

1705- Dhera

Pika 20 Mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje Industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë Fraksionet e mbledhura veçmas

20 01 01- Letër dhe karton

20 03 03- Mbetje nga pastrimi i rrugeve

20 03 04- Llumra nga gropat septike

20 01 08- Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat

Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet fiziko - kimike të mineraleve

01 01 01 Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve metalore

01 03 08 Mbetje pluhurash, përveç atyre të përmendura në rubrikën 01 03 07; 01 03 09

01 04 13 Mbetje që vijnë nga prerja dhe sharrimi i gurëve, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07; 01 04 99

6.4.2 Trajtimi i mbetjeve

Mbetjet inerte te gjenaruara do te trajtohen sipas VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, eshte vete gjeneruesi (ne kete rast subjekti Elbesa sh.p.k) I cili do te largoje/transportoje mbetjet e gjeneruara ne landfillet inerte te percaktuara nga Bashkia/ Njesia e Qeverisjes Vendore.

Mbetje vajrash dhe mbetje te karburanteve te lëngshme, qe klasifikohen si mbetje te rrezikeshme do te trajtohen sipas VKM Nr. 765 date 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”, Kreu IV ne piken 6 ku citohet: Kur krijuesi i VP-ve është person që ka në përdorim vetjak automjete dhe kur ndërrimin e vajit e bën vetë, vajin e përdorur e depoziton në enë të veçanta dhe e dorëzon te subjekti që është pajisur me licencën III.2.B, për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e VP-ve.

Mbetjet e biodegradueshme qe do te gjenerohen ose mbetjet e gjelberta qe ketu futet druri, ku bejne pjese pemet qe do te priten apo zhvendosen nga zhvillimi I aktivitetit, gjithashtu edhe mbetjet nga pastrami i rrigeve qe mund te jete krahsitja, do te trajtohen sipas VKM nr. 608, datë 17.9.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”. Sugjerohet qe mbetjet e drurit te perdoren per dru zjarri per banoret e zones, pork jo me pare duhet te percaktohet nga njesia e qeverisjes vendore per destinacionin e tyre.

Mbetjet nga gomat e perdorura te automjeteve do te trajtohen sipas VKM nr. 652, datë 14.9.2016 “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura” ku ne piken 5 citohet: Zotëruesi (ne kete rast subjekti **Elbesa sh.p.k**) i gomave të përdorura i dorëzon pa pagesë gomat e përdorura te grumbulluesi dhe/ose te magazinuesi dhe/ose te trajtuesi i gomave të përdorura. Në rastin e zëvendësimit të gomave të përdorura me goma të reja në pikat e servisit, zotëruesi i gomave të përdorura i dorëzon ato te servisi.

Mbetjet e urbane te riciklueshme ne kete rast futen kartoni, qelqi dhe plastika qe do te gjenrohen do te trajtohen sipas Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar. Ne kantierin e punes do te vendosen 3 kosha ku do te vendosen ne kantierin e punes dhe do te zbrazen ne frokuence ditore.



Figura 21- Sistemi i menaxhimit te mbetjeve ne kantierin e ndertimit

- Ngjyra:Jeshile (Organike)
- Verdhe:Plastike /qelq

- Blu:(Letër & Karton)

Keto mbetje do te dergohen ne vendin e grumbullimi te percaktuar nga Bashkia/ Njesia e Qeverisjes Vendore, pasi klasifikohen ne mbetje urbane.

Llumrat nga gropat septike do te trajtohen sipas Vkm nr. 127, datë 11.2.2015 “Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura” ne kreun I pika dh citohet: “Impiant individual ose lokal trajtimi i ujërave të ndotura” është gropa septike, gropa e ujërave të zeza, gropa e banjave, banja në oborr me gropë ose drenazhi francez, i cili shërben për trajtimin në vend të ujërave të ndotura, në zonat ku nuk ka sistem publik kanalizimesh;

Sugjerohet qe ne kantierin e punes te perdoren tualeta portativ pasi jane te levisshem dhe puna do jete ne disa fronte.




Figura 22- Shembull i nje tualeti portativ

6.4.3 Transportimi i mbetjeve

Transportimi i mbetjeve do te behet nga persona te autorizuar me licence te tipit III.2.B si detyrim i ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar.

6.4.4 Asgjesimi i mbetjeve

Materiali qe do te depozitohet eshte kryesisht materiali me perberje shkembore, aluvione te cimentuara, si dhe materialet me perberje guresh te cilat do te depozitohen me vete dhe do te perdoren si mbulesa e ketyre vend-depozitimi ne menyre qe me kalimin e kohes vegjetacioni ne keto zona mund te zhvillohet. Gjithashtu i gjithe materiali qe do te depozitohet do ngjishet, dhe neqoftese eshte e nevojshme do te krijohen te gjitha kanalet drenazhuese perreth venddepozitimit ne menyre qe ujerat siperfaqesore te mos pengohen nga rrjedhja e tyre. Projektimi i ketyre vend-depozitimeve do te behet ne menyre te tille ku jane evituar te gjitha konfliktet me objektet qe ndodhen ne kete zone, duke iu shmangur edhe zonave te banuara ne menyre qe te eliminohen edhe rrisqet me te vogla nga prania e ketyre venddepozitimi.

Gjithashtu per te ruajtur keto depozitime nga erozioni apo shkarjet do te behet nje ngjeshje e mire e saj per te shmangur fundosje te ketyre shtresave te tokes. Per te zvogeluar efektin e shpelarjeve te ketyre siperfaqeve nga rreshjet e shiut pjerresite e nevojshme me kanalet e hapura do te formohen ne siperfaqet e ketyre venddepozitimi.

Megjithese nuk paraqitet e nevojshme, por nqs do te jete e tille ne fund skarpatat e ketyre venddepozitimi mund te ndertohen mure mbajttese (Gabion) lokale me ane te materialit shkembor (Gure te Medhenj) ne menyre qe te evitohen rreshqitjet.

Shkarkimi i materialeve ne shesh-depozitim do te kryhet sipas nje radhe te caktuar qe do te thote, materialet do te shkarkohen me shtresa.

Kompania investitore parashikon qe te recikloje pjesen e materialit materialin e ngurte ne rruget e aksesit duke reduktuar koston e materialeve inerte nga lumenje edhe mbrojtjen e errozionit e zones. Nese do te kete materiale qe do te teprojne ato do te trajtohen sipas menyres se mesiperme dhe ne bashkepunim me institucionet lokale te zones.

7. LIDHJET E MUNDESHME TE PROJEKTIT ME PROJEKTE TE TJERA EKZISTUESE, PRANE ZONES SE PROJEKTIT

7.1 Lidhja e projektit me infrastrukturen e zones

Lidhja me infrastrukturen e zones eshte nepermjet rruges automobilistike Librazhd-Prrenjas ne vendin e quajtur ura e Bushtrices. Deri ne vendin e projektit eshte rruge rurale (e pasafaltuar) afer 4.2 km. Kjo rruge do te permirsohet edhe mirembahet nga kompania gjate proceseve te punes.

Projekti ne fjale eshte ne politikat e Shtetit Shqiptar, perkatesisht Ministrise se Infrastruktures edhe Energjise ne planin e saj per shfrytezimin 3-vjecar te minerave te cilat kane qene te shfrytezueshme edhe me pare. Nga studimet edhe vezhgimet ne keto miniera ka rezerva te tjera Kromi qe mund te shfrytezohen per nje afat te caktuar. Bazuar ne VKM nr.248, datë 02.05.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 347, datë 29.4.2011 të këshillit të ministrave "për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare", dhe Urdhrit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 107, datë 10.03.2014 "Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2014", i ndryshuar, eshte hape gara per marrjen pjese e kompanive per shfrytezimin e zonave minereare me numer: Nr. 165/4, Nr. 289/4, Nr. 516/7, Nr. 521/1, Nr. 367/7. Ne zonen minerare Nr. 516/7 Skroske, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan, kompania Elbesa sh.p.k eshte shpallur fituese per shfrytezimin e Minieralit te Kromit per nje periudhe 3 vjecare.

7.2 Alternativat e marra ne konsiderate per vendodhjen e projektit dhe teknologjise qe do te perdoret

Duke pasur parasysh dhe shqyrtuar me kujdes :

- Pozicioni i trupit xeherore ne plan dhe prerje;
- Vendosjen e punimeve ekzistuese ne raport me trupin xeherore;
- Trashesine e trupit te hedhur ne keto galeri sipas dokumentimeve te kryera;
- Kendet e renies dhe zhytjes se trupave dhe lidhjes mes tyre.

Mendojme qe punimet e reja per shfrytezimin e mbetjeve teknologjike dhe te trupave mineral te pjeses mbi kuoten +560 dhe nuk do te duhet te hapen. Punime minerare te mirfillta do te hapen per shfrytezimin e rezervave mbi koten +535 dhe asj mbi kuoten +510m Ne keto kushte meqenese shpimet kane kapur trupin ne kuoten +535 nen kete kuote do te jente e nevojshme te kryhen punime shpimi nentokesore, ne se gjate kryerjes se punimeve te shfrytezimit te ketij paneli , nga sherbimi gjeologjik rezulton e nevojshme.

- Punimet do te kryhen gjithnje ne anen e shtruar per te evituar rrezikun qe mund te vije nga ndonje punim shfrytezimi apo punim minerar, por qe nuk eshte i hedhur ne dokumentacionin i cili eshte siguruar nga shoqeria ne rruge private. Kjo eshte edhe arsyeja qe punimet nuk jane saktuar pasi pas ringritjes se punimeve do te behet azhornimi i tyre topografik e gjeologjik.
- Paraprakisht mendohet se jane per tu ringritur 20-30% e volumit te pergjithshem te punimeve. Do te hapen traversa nga punimet ekzistuese te hapura vite me pare, por qe do te ringrihen me marrjen e kesaj leje. Keto traversa, do te sherbejne si traversa zbulimi per drejtimet qe mendojme se nuk eshte bere ky zbulim, por edhe si fronte pune nga do te vilet materiali i celiqeve qe jane lene me pare nga shfrytezimi

Objekti "Skroske" eshte hapuar dhe punimet minerare jane vendosur per nje menyre te caktuar shfrytezimi, qe eshte perdorur ne kete miniere, por ne pergjithesi edhe ne minierat e tjera te kromit te vendit tone. Kushtezuar nga pozicioni hapsinor i trupave te mineralizuar shfrytezimi do te jete nentokesor. Ne zgjedhjen e menyres se shfrytezimit ndikojne nje sere faktoresh te cilet do te merren ne konsiderate, qe me kryesoret jane:

- Menyra e pergatitjes se bllokut
- Shfrytezimi pa rrezik i trupit xeheror dhe kushte te mira ajrimi ne bllok
- Kushte te mira dhe siguri per levizjene njerezve, maqinerive e materialeve neper punim.
- Hubje minimale e mineralit ne celiqet qe sherbejne per te mbrojtur punimet perгатitore.
- Kushte te favorshme dhe rendiment te kenaqshem ne ngarkim e transport.
- Shpenzime minimale per mbajtjen e punimeve dhe mirembajtjen e armaturave.
- Drejtimit shfrytezimit do te jete shfrytezim nga lart-poshte, ndersa e bllokut nga kufir per ne gender.

Nga sa jemi informuar dhe nga fakti se per trupa te tille ne shfrytezim ne kete miniere eshte perdorur sistemi i shfrytezimit me galeri nenkati. Ky sistem rekomandohet edhe ne te ardhmen ku lartesia e katit do te jete ne vartesi te dimensioneve ne renie te trupave minerare, pasi sipas shkalles se njohjes se trupave ne kete vendburim ka luhate te medha dhe trashesi e trupave eshte e vogel. Lartesi e nenkatit do te jete 5-6-8 m, por gjithnje kjo do te gjykohet sipas situates konkrete. Lartesi kati per panelin +535-+570 do te jete 35m ndersa ndersa nen nivelin +510 do te jete 25m. Per pjesn nen kuoten +510m, ne varertesiti te rezervave qe eventualisht mund te zbulohen do te percaktohet ne nje faze te mevonshme me projekt qe do te hartohet nga drejtuesit e minieres. Kjo eshte e kushtezuar edhe nga ekzistenca e trupave te mineralit te cilat ne kete vendburim jane mjaft te coptuar nga tektonike dhe

te paqendrueshem ne trashesi. Per mbetjet e shfrytezimit do te hartohet pasaporte e veçante per shfrytezimi e secilit sipas kushteve specifike duke u realizuar gjithnje ne prezence te drejtuesit teknik.

- Gjatesia e bllokut 16-20-25m
- Lartesia e nenkatit 5-6-8m
- Largesia e hinkave te vjelejes se mineralit 4-6m.

Per rrezimin e mineralit do te perdoren bira me thellesi 2-2.5m. Birat do te behen me çekiçe shpues te zakonshem me mbajtese pneumatike, ne tavan te galerise se nenkatit. Marrja e bllokut, sipas rrethanave do te behet nga kufiri per ne qender mbasi blloku parashikhet te pergatitet me oxhak ne qendert e tij . Gjatesia e nenkatit eshte e vogel 15-18 m dhe oxhaku qendror ne profilin 2-2 e ndan ate ne dy pjese relativisht te shkurtra.

7.3 Perdorimi i lendeve te para gjate funksionimit (shfrytezimit) ,uje ,energji ,lende djegese dhe menyra e sigurimit te tyre

Lenda e pare qe do te perdoret eshte energjia elektrike, uje edhe nafta. Energjia elektrike kryesisht do te perdoret per ndricim, zyra edhe per kompresorin e ajrit. Gjashtu edhe per pompimin e ujit kur eshte e nevojshme. Kur eshte e nevojshme do te perdoren edhe ventilatore ajrimi ne minere cka frunizohen me energji elektrike. Energjia elektrike do te sigurohet nga gabina elektrike e fshatit qe ndodhet aty afer.

Uji do te perodret kryesisht ne procesin e perdorimit te cekisit pneumatik per te reduktura pluhurat. Gjithashtu edhe per nevojat e zyres edhe uje i pijshem. Sigurimi i ujit do te behet nga burimet e zones edhe me autobote ose me ane te vendosjes se nje pompe.

Lende djegese, nafta kryesisht do te perdoret per makinerit e ngarkim shkrakimit qe jane kamiona ose vinca per ngritjen edhe transportimin e mineralit. Nafta do te sigurihet me ane te nje boti qe do te furinizoje makinerite sipas nevojës se proceseve te punes. Nafta do te merret nga karburantet qe gjenden ne rrugen automobiliistike Librazhd-Prrenjas.

7.4 Aktivitete te tjera qe nevojiten per zbatimin e projektit (ndertimi i kapanoneve apo rezidencave).

Aktiviteti tjetër është ngritja e kantierit të ndertimit para fillimit të punimeve si dhe pergatitja planit të organizimit ku do të shihen mundësitë që punimet të kryen në disa fronte, për të minimizuar kohën e ndertimit dhe shfrytezimit të projektit. Gjithashtu konsultimi me banorët e zones në rast të ndonjë konflikti gjatë periudhës së ndertimit dhe shfrytezimit. Mbajtja kontakte me pushtetin lokal dhe ministrinë e linjes për çdo problem gjatë shfrytezimit të projektit të projektit.

8. INFORMACION PER LEJET ,AUTORIZIMET DHE LICENSAT ,SIPAS LEGJISLACIONIT NE FUQI,PER LEJIMIN,AUTORIZIMIN, LICENSIMIN E PROJEKTIT

Shoqëri Elbasa Sh.p.k është shpallur fituese për shfrytezimin e minierës së Kromit me Nr. 516/7 Skroske, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan për një periudhë 3 vjeçare me ane të shkresës datë 27.10.2020 Nr. Prot. 7572/1 nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës edhe Energjisë për aplikimin për leje Minerare të zones në fjalë. Përveçse lejes Minerare, në bazë të legjislacionit në fuqi, kërkohej

edhe leje mjedisore per kete aktivitet, ku se pari duhet ti neshetrohet procedures se VNM-se se thelluar. Per procedurat e VNM-se se thelluar do te behet edhe nje konsultim me publikun e zones edhe aktoret lokal per te marre mendimet e tyre edhe sugjerimet ne lidhje me projektin qe do te zhvillohet.

9. KOPJE TE LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE LICENSIVE QE DISPONON ZHVILLUESI PER PROJEKTIN E PROPOZUAR , NE PERPUTHJE ME PERCAKTIMET E BERA NE LEGJISLACIONIN NE FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOPRETEENTE PER LEJIMIN/AUTORIZIMIN/LICENSIMIN E PROJEKTIT.

Bashkangjitur eshte shkresa per njoftimin e te drejtese se aplikimit per leje minerare nga ana e Ministrise se Infrastruktures edhe Energjise date 27.10.2020 Nr. Prot. 7572/1.

Expert Mjedisi. Kristaq GJOKA



Expert Mjedisi Yzeir MIRAKA



MSc. Ing. Mjedisi Bestar CEKREZI



KONSULENTI:

ZENIT & CO SH.P.K.

ADMINISTRATORI

ARQILE PERI



ZENIT CO
K6173100
2D

Digitally signed
by ZENIT CO
K61731002D
Date: 2021.01.28
10:37:52 +01'00'

INVESTITOR:

ELBESA SH.P.K

ADMINISTRATORI

BESNIK PISHA



TIRANE, Janar 2021

(Azhornuar)



LN-7695-03-2014	NUIS/NIPT: K61731002D
Subjekti: ZENIT - 06	
Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Rruga "Myrteza Topi", Nd.18, Ap.38	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 26/03/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	
Nënkategoria	
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	
1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	
Specialiteti	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor, vlerësimi i ndikimit në mjedis)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i sportelit:

Limzo